

**PLANI I VEPRIMIT PER  
ZBATIMIN E STRATEGJISE  
KOMBETARE TE  
DIASPORES**

---

**BULETIN**

**Nr. 1      Qershor 2023**

---

AGJENCIA  
KOMBËTARE  
E DIASPORËS



# PËRMBAJTJA

---

HYRJE	3
QËLLIMI I BULETINIT	4
ZBATIMI I MASAVE 2021 - 2025	5

## Hyrje

Diaspora shqiptare ka dhënë ndër vite një kontribut të çmuar për zhvillimin ekonomik e shoqëror në atdhe. Duke u bazuar në kontributin dhe potencialet e diasporës shqiptare, institucionet shtetërore vijnë me zhvillimin dhe zbatimin e politikave shtetërore gjithëpërfshirëse për marrëdhëniet e shtetit shqiptar me diasporën.

Strategjia Kombëtare e Diasporës (2021-2025) dhe Plani i Veprimit, miratuar me Vendimin Nr.585/2020, të Këshillit të Ministrave, është një ndër dokumentet thelbësore mbi politikat e reja për diasporën. Ky dokument është vazhdim i veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024 e cila e ka përmbyllur ciklin e saj në 31 dhjetor 2020. Strategjia konsiderohet si një hap i rëndësishëm i reformës shtetërore për diasporën dhe synon të ndërtojë një bashkëpunim gjithëpërfshirës me komunitetet e diasporës. Objektivat e Strategjisë realizohen nëpërmjet zbatimit të 72 (shtatëdhjetë e dy) masave të Planit të Veprimit.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo gjashtë muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit.

Buletini Nr.1 (Qershor 2023) është buletini i cili jep një informacion i detajuar mbi ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 nga institucionet shtetërore përgjegjëse për politikat e Diasporës. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave shtetërore për diasporën. Gjithashtu, publikimi i buletinit informon anëtarët e strukturave vendimmarrëse lidhur me politikat ekzistuese, sukseset e arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë reformës shtetërore për diasporën.

Buletini mbetet një dokument i hapur për çdo vërejtje dhe sugjerim. Institucionet, grupet e interesit, publiku, media dhe qytetarët janë të mirëpritur për propozimet e tyre, të cilat do të shërbejnë për fuqizimin e bashkëpunimit me diasporën.

**Agjencia Kombëtare e Diasporës**  
**Tiranë**  
**Qershor 2023**

## BULETINI Nr.1, Qershor 2023

**QËLLIMI I PUBLIKIMIT TË BULETINIT “PËR ZBATIMIN E MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS 2021 - 2025” ËSHTË INFORMIMI I:**

1. ANËTARËVE TË KOMITETIT SHTETËROR TË DIASPORËS MBI ECURINË E PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS (2021-2025), MIRATUAR ME VENDIMIN NR.585/2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE.
2. ANËTARËVE TË NËNKOMISIONIT PËR DIASPORËN DHE MIGRACIONIN NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË POLITIKËS SË JASHTME TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, NGRITUR ME VENDIMIN NR.98/2017, TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË.
3. INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS.
4. PUBLIKUT TË INTERESUAR PËR ECURINË E REFORMËS NË FUSHËN E MARRËDHËNIEVE ME DIASPORËN SHQIPTARE.

# **MASAT E PLANIT TE VEPRIMIT 2021-2025**

## | Masa Nr. 1 |

Koordinimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse që legjislacioni i ri ngarkon për fushën e marrëdhënieve shtetërore me diasporën me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendrën e Botimeve për Diasporën dhe Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Hartimi i një plani të detajuar për financimin e politikave dhe masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare. Krijimi i një njësie të specializuar për rivlerësimin e legjislacionit për diasporën për të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme.

**INDIKATORËT :** Forcimi financiar dhe me personel i Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministri i Financave dhe Ekonomisë

**Janar-Mars 2021:**

- U miratua Ligji Nr. 35/2021 “Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” datë 16.3.2021. Ndryshimet ligjore synojnë të rregullojnë elementë proceduralë të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe të unifikojnë kuadrin rregullator ligjor në përputhje me zhvillimet gjatë këtyre viteve të funksionimit të saj.
- U miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.430 datë 30.06.2021 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme, kritereve dhe procedurave specifike për marrjen me qira të ambienteve dhe lidhjen e kontratave të veçanta me bashkëpunëtorë të jashtëm ose figura të njohura shqiptare në diasporë, të cilat nevojiten të kryhen me qëllim zbatimin dhe realizimin e programit vjetor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe që nuk rregullohen nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.” Akti nënligjor përcakton rregullat dhe procedurat specifike për aktivitetet e natyrës së veçantë dhe specifike që mbulon fusha e veprimtarisë së AKD-së.
- Në zbatim të Strategjisë Kombëtare e Diasporës (2021-2025) dhe Planit të Veprimit, miratuar me Vendimin Nr.585/2020 të Këshillit të Ministrave, me qëllim asistimin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e saj, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ka kontraktuar 6 (gjashtë ekspertë) të profileve të ndryshme pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bankës së Shqipërisë dhe Institutit të Statistikave. Ekspertët do të japin kontributin e tyre në mbështetjen e këtyre institucioneve për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
- Në zbatim të programit “Angazhimi i Diasporës në zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë”, me ndihmën e zyrës së IOM në Tiranë, janë përzgjedhur 20 (njëzetë)

ekspertë, të cilët jetojnë në vende të ndryshme jashtë Shqipërisë dhe i përkasin diasporës shqiptare. Këta ekspertë do të ndihmojnë administratën shqiptare në procesin e negocimit të integritit evropian të Shqipërisë.

- Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën Nr.1014 Prot, datë 23.02.2021 “Kërkesë për përfshirjen në Grupin Ndërinstitucional të Punës për kapitujt e negociatave” drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Kryenegociatorit Kombëtar IPA ka propozuar përfshirjen në Grupin Ndërinstitucional të Punës, të Agjencisë Kombëtare të Diasporës duke ju referuar fushës së kompetencave dhe veprimtarisë së ushtruar për kapitujt të Acquis të Bashkimit Evropian: 25-Shkenca Kërkim Shkencor; 26- Arsim dhe Kulturë. Referuar kësaj kërkesë, Agjencia Kombëtare e Diasporës sipas fushës së kompetencave dhe veprimtarisë është përfshirë në datën 18.03.2021 në Grupin Ndërinstitucional të Punës në lidhje me kapitujt e Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian për Kapitullin 26 -Arsim dhe Kulturë. Pjesëmarrja në këtë grup ndërinstitucional synon të realizojë përfshirjen e diasporës dhe kontributin e saj drejt integritit të Shqipërisë, si pjesë e Bashkimit Evropian

### Prill-Qershor 2021:

- Për krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, nga institucionet shtetërore të Diasporës, janë zhvilluar aktivitete të përvitshme. Ndër këto aktivitete në këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:
- Në datën 7 Qershor 2021 u zhvillua aktiviteti vjetor “Takimi i Juristëve në Diasporë”. Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Drejtësisë zhvilloi aktivitetin në mënyrë të alternuar fizikisht dhe online “Takimi i Juristëve në Diasporë”. Diskutimi u zhvillua në tre panele: “Vështrim i përgjithshëm”, “Juristët në diasporë dhe roli i tyre në sistemin e drejtësisë” dhe “Rrjetëzimi dhe ndërveprimi i profesionistëve në diasporë”.
- Në datën 16 Qershor 2021 u zhvillua aktiviteti “Dita Ndërkombëtare e Remitancave”. Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Bankës së Shqipërisë, zhvilloi aktivitetin “Dita Ndërkombëtare e Remitancave”, duke vlerësuar rolin e remitancave në ekonominë e vendit si dhe formalizimin e kanaleve të dërgimit të tyre në atdhe, objektiva kryesorë edhe të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.
- Në datën 22 qershor 2021 u zhvillua aktiviteti vjetor “Takimi i Mësuesve të Diasporës”. Takimi i Mësuesve të Diasporës 22 qershor 2021. Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë organizoi më 22 qershor 2021 “Takimin e Mësuesve të Diasporës”. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve të përfshira në procesin e mësimin në Diasporë në Republikën e Kosovës, znj. Arbërie Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës si dhe znj. Liza Gashi, Zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë, të cilat diskutuan lidhur me sfidat dhe problematikat që hasin mësuesit jashtë vendit.Ky u organizua në 3 panele: Në panelin e parë u prezantua puna e realizuar nga dy Qeveritë e Shqipërisë dhe e Kosovës, për pajtimin, për regjistrimin e përbashkët të mësuesve në diasporë, për ratifikimin dhe vijimësinë e marrëveshjeve të hartuara, për organizimet e përbashkëta të aktiviteteve dhe seminareve, për mundësimin e trajnimeve për mësuesit në diasporë, për nxitjen e marrëveshjeve me vendet pritëse për mbështetjen e mësimin të gjuhës shqipe aty ku jetojnë shqiptarët, etj. Në panelin e dytë u diskutua

çështja e organizimit të mësimdhënien në diasporë dhe në panelin e tretë mësuesit shkëmbyen përvojën e tyre në mësimdhënien e gjuhës shqipe në diasporë.

### Korrik-Dhjetor 2021:

Zbatimi i masës nr.1 lidhet me 6 mujorin e parë të vitit 2021, informacion plotësues pasqyrohet dhe për periudhën korrik-dhjetor 2021.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, nëpërmjet shkresës Nr. 8728, datë 14.07.2021, me lëndë: “Sugjerim për Kandidaturë” drejtuar Ministrit të Shtetit për Diasporën, informon mbi përfaqësimin e Znj.Megi Fino, Zvendësministre për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme në funksione të përfaqësimit në strukturat e Diasporës, konkretisht:
  1. Kryetare e Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.
  2. Anëtare e Grupit të Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025.
  3. Koordinator për marrëveshjetet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, nëpërmjet shkresës nr. 8129 prot., datë 02.07.2021, informon mbi përfaqësimin e MEPJ-së në Këshillin Koordinues të Qendrës së Botimeve për Diasporën.

*NË PROCES*

### **| Masa Nr.2 |**

Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor të aktiviteteve për diasporën (aktivitetet që përfshinë librin, arsimin, kulturën, turizmin dhe biznesin) dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë vlerësimin e pjesëmarrjes e përfaqësimit në to. Përgatitja e informacioneve vlerësuese për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin e Kuvendit për Diasporën dhe Migracionin.

**INDIKATORËT:** Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor të aktiviteteve për diasporën.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria e Kulturës
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Korrik-Dhjetor 2021:



- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka përcjellë me mjete të komunikimit elektronik kalendarin e festave lokale të planifikuara për vitin 2021 dhe informon se ka për qëllim promovimin e turizmit, traditave, vlerave kulturore dhe historike si dhe produkteve vendase.

NË PROCES

### || Masa Nr.3 ||

Ndjekja e procedurave të nevojshme koordinative për të diskutuar çdo vit në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe për të parashikuar në buxhetin vjetor (pasardhës) fondet e nevojshme për të zbatuar Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit deri në vitin 2025.

**INDIKATORËT :** Diskutimi dhe miratimi në parim i nevojave dhe buxhetit vjetor në Komitetin Shtetëror të Diasporës.

**AFATI KOHOR:** 6 maji i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Kulturës

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën Nr. 3061/1, datë 27.08.2021, informon se vlerësohet e nevojshme ngritja e një grupi pune për hartimin e një raporti të detajuar mbi efektet financiare që do të ketë marrëveshja e bashkëpunimit për financimin dhe organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.

NË PROCES

### || Masa Nr.4 ||

Vlerësimi i përjasjes të strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Diasporën. Ky proces do të kryejë organizimin e politikave shtetërore ekzistuese apo që do të miratohen në të ardhmen në marrëdhënie me politikat për komunitet shqiptare jashtë vendit.

**INDIKATORËT :** Realizimi i një takimi vjetor në nivelin teknik për përjasjen e Strategjisë Kombëtare të diasporës me strategjitë e tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen.

**AFATI KOHOR:** 6 maji i parë 2021 (periodike deri në 2025)

## **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**
- **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**
- **Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes**

### **Janar-Mars 2021:**

- Është në proces të konsultimit publik Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027, referuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në të cilën vlerësohet potenciali i njohurive dhe burimeve të diasporës për zhvillimin e mëtejshëm të ekosistemit të startup-eve dhe inovacionit. Nëpërmjet masave të parashikuara në Planin e Veprimit dhe granteve përkatëse nga Buxheti i Shtetit ose donatorët do të synohet tërheqja e investitorëve të huaj dhe investitorëve të diasporës në vendin tonë.
- Është miratuar me Vendim Nr.400, datë 19.06.2019 të Këshillit të Ministrave Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019-2022. Strategjia ka për qëllim të ofrojë përgjigje gjithëpërfshirëse dhe të plota ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit në kontekstin e Shqipërisë. Ky dokument synon të sigurojë një kornizë unifikuese të parimeve të përbashkëta dhe angazhimeve ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë, duke përfshirë dimensionet humanitare, të zhvillimit dhe të të drejtave të njeriut, si dhe duke përmirësuar bashkëpunimin dhe koordinimin institucional për migracionin.
- Është draftuar me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) në Shqipëri, Strategjia e Komunikimit dhe Planit të Veprimit 2021-2025, në kuadër të projektit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë”. Kjo Strategji synon të mbështesë përpjekjet e përbashkëta të Ministrit të Shtetit për Diasporën, institucionet e lidhura me angazhimin e Diasporës, shoqatat e Diasporës dhe përfaqësuesit e tyre, me qëllim integrimin e Diasporës shqiptare në jetën shoqërore, kulturore dhe ekonomike të Shqipërisë.
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës dhe studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për gjuhën, historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh.
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Muzeut Historik Kombëtar, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës dhe studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh dhe publikimin e tyre.

### **Prill-Qershor 2021:**

- Është miratuar Urdhri nr. 35, datë 10.03.2021 i Kryeministrit “Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Drejtues për Migracionin me qëllim zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe të Planit të Veprimit 2019-2022”. Anëtar i këtij Grupi Drejtues është dhe Ministri i Shtetit për Diasporën. Ky Grup ka funksion mbikëqyrjen e progresit të përgjithshëm në arritjen e objektivave të politikave strategjike të

migracionit dhe përmirësimin e mekanizmave të bashkërendimit.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcjellë shkresën nr. 6563 Prot., datë 12.04.2021 “Kërkesë për raportim” drejtuar Ministrit të Shtetit për Diasporën ku kërkon informacion për nivelin e zbatimit të Masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019-2022. Ministri i Shtetit për Diasporën me shkresën nr. 1924/1 Prot., datë 11.05.2021 informon mbi zbatimin e Masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019-2022.
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Kjo marrëveshje synon bashkëpunimin e ndërsjellë institucional me qëllim:
  - Hartimin, seleksionimin, përshtatjen, përmirësimin e teksteve shkollore dhe literaturës plotësuese për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë;
  - Ofrimin e përvojës për didaktikën e mësimdhënies së gjuhës shqipe jashtë vendit si dhe përgatitjen e materialeve didaktike të mësimdhënies në shërbim të një platforme digjitale të mësimin të gjuhës shqipe;
  - Organizimin e aktiviteteve dhe konferencave të përbashkëta shkencore për trajnimin e mësuesve në diasporë;
  - Krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës. Kjo marrëveshje synon bashkëpunimin e ndërsjellë institucional me qëllim:
  - Hartimin, seleksionimin, përshtatjen, përmirësimin e teksteve shkollore dhe literaturës plotësuese për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë në kuadër të programit të botimeve dygjuhëshe;
  - Ofrimin e përvojës për përgatitjen e botimeve dygjuhëshe si dhe përgatitjen e materialeve didaktike të mësimdhënies në shërbim të një platforme digjitale të mësimin të gjuhës shqipe, si gjuhë e dytë;
  - Organizimin e aktiviteteve dhe konferencave të përbashkëta shkencore për trajnimin e mësuesve në diasporë;
  - Krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta në thirrjet e projekteve të publikuara nga donatorë të ndryshëm etj.
- Në datë 16.04.2021, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është nxitja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës, studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh, për lidhjet kulturore dhe historike ndërmjet komunitetit arbëresh dhe arealit kulturor të Veriut pasi të parët që i kushtuan vëmendje gjuhës dhe letërsisë arbëreshe, ishin autorë të arealit kulturor të Veriut;
- Në datë 15.06.2021 është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi për sigurimin e kushteve të përshtatshme dhe të mundshme për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme në fushën e shkencës, kulturës dhe promovimit

të përbashkët të aktiviteteve.

- Në datë 15.06.2021 është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve, Shkup. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës, studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh, për lidhjet kulturore dhe historike ndërmjet komunitetit arbëresh të Italisë së Jugut dhe Arbëreshëve të Zarës në Kroaci.
- Në datë 15.06.2021 është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Universitetit “Nënë Tereza”, Shkup. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës, studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh, për lidhjet kulturore dhe historike ndërmjet komunitetit arbëresh të Italisë së Jugut dhe Arbëreshëve të Zarës në Kroaci.

### Korrik-Dhjetor 2021:

Zbatimi i masës nr.4 lidhet me 6 mujorin e parë të vitit 2021, informacion plotësues pasqyrohet dhe për periudhën korrik-dhjetor 2021.

- Ministër Shteti për Ndhimën Zhvillimore Jashtë Shtetit dhe Diasporën Irlandeze, nëpërmjet shkresës datë 21 dhjetor 2021, informon mbi vendosjen e komunikimeve dhe bashkëpunimit zyrtar për çështje lidhur me diasporën dhe strategjinë ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Autoriteteve Irlandeze në fushën e Diasporës, dhe vijimin e komunikimit zyrtar në fillim të vitit 2022.

NË PROCES

### **Masa Nr.5**

Realizimi i raporteve vjetore nga institucionet përgjegjëse ku të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi për komunitetet shqiptare në shtetet pritëse. Krijimi i një botimi të përbashkët për raportimet për diasporën shqiptare.

**INDIKATORËT :** Realizimi i raportit vjetor për diasporën shqiptare Instituti i Statistikave dhe Banka e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

### Korrik-Dhjetor 2021:

-Agjencia Kombëtare e Diasporës informon se ka hartuar raport vjetor ku pasqyrohen të dhëna dhe vlerësime për komunitetet shqiptare në shtetet pritëse. Gjatë vitit 2021,

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka realizuar programin vjetor me komunitetet shqiptare kudo në botë dhe ka draftuar raport përmbledhës për punën me komunitetet.

NË PROCES

## Masa Nr.6

Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit me shtetet pritëse me qëllim përfshirjen në këto marrëveshje të formimit profesional, ose për to të diskutohet në veçanti.

Rivlerësimi në bashkëpunim me vendet e BE-së e projekte të veçanta për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve të punësimit duke përfutur edhe nga legjislacioni provizor dhe i veçantë i vendeve pritëse, që kanë mungesë të fuqisë punëtore.

**INDIKATORËT :** Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit dhe bashkëpunimi me vendet e BE-së për projekte të veçanta. Raportim vjetor në Komitetin Shtetëror të Diasporës.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Janar-Qershor 2022:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme përmes korrespondencës elektronike informon se në çdo takim kryhet trajtimi me përfaqësuesit e shteteve të tjera për diskutimin e marrëveshjeve për sigurimet shoqërore për shtetasit shqiptar që jetojnë dhe punojnë jashtë.

Shqipëria aktualisht:

- Ka 12 (dymbëdhjetë) marrëveshje të nënshkruara për Mbrojtjen Sociale,
- Është në proces negociimi për 12 (dymbëdhjetë) marrëveshje,
- Ka iniciuar 8 (tetë) marrëveshje të reja,
- Është në proces vlerësimi për 2 (dy) marrëveshje,
- Do të mbajë të ngrira 2 (dy) marrëveshje.

Konkretisht:

Janë 12 Marrëveshje Bilaterale të nënshkruara për Mbrojtjen Sociale: Austri, Belgjikë, Çeki, Gjermani, Hungari, Kanada, Kosovë, Luksemburg, Maqedoni e Veriut, Rumani, Turqi, Zvicër. (Kanada dhe Kosove hyjnë në fuqi gjatë viti 2022)

Janë 12 Marrëveshje në proces negociimi:

Arabi Saudite, Bullgari, EBA, Greqi, Holandë, Itali, Kroaci, Mali i Zi, Poloni, Serbi, Spanjë, SHBA,

Është treguar interes për negocimin me 8 vende:

Australi, Danimärke, Francë, Mbretëri e Bashkuar, Vendet Nordike (4- Suedi, Norvegji, Islandë, Finlandë).

Janë në proces vlerësimi marrëveshjet me 2 vende:

Moldavi, Slloveni.

Mbeten të ngrira negocimi i 2 marrëveshjeve:

Indi, Izrael.

NË PROCES

### **Masa Nr.7**

Organizimi i nxitjes e forcimit të marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare dhe bashkëpunimi i programit të punës të shërbimit diplomatik dhe konsullor me fokus të veçantë nga këndvështrimi i forcimit të statusit të diasporës shqiptare.

**INDIKATORËT** : Organizimi i një aktiviteti vjetor për vlerësimin e strukturës së përfqësimit diplomatik dhe konsullor.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka raportuar përmes komunikimit elektronik lidhur me përditësimin e numrit të aplikimeve të realizuara nga shërbimet konsullore jashtë vendit. Në periudhën qershor - dhjetor 2021 janë realizuar gjithsej nga shërbimet tona konsullore jashtë : Kartë ID + Pasaportë: 65.983, veprime të tjera konsullore: 48.077
- Përveç shtimit të zyrave konsullore për aplikime për pasaporta dhe ID, MEPJ në bashkëpunim me Ambasadën Shqiptare në Athinë dhe autoritetet greke, mundësoi shërbime në ishujt Rodos dhe Kretë për të gjithë qytetarët shqiparë të cilëve iu kishte mbaruar afati i pashaportës dhe ID.
- Është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë të Shtetit për Diasporën për Vlerësimin dhe promovimin e artit dhe kulturës në diasporën shqiptare. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është krijimi i modelit të bashkëpunimit, me qëllim vlerësimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të artit dhe kulturës të pjesëtarëve të diasporës, ruajtjen e traditave kombëtare kulturore, si dhe nxitjen e shtrirjes së tyre.

## Janar-Qershor 2022:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në bashkëpunim me Ambasadën Shqiptare në Athinë dhe autoritetet greke, mundësoi shërbime në ishujt Rodos dhe Kretë për të gjithë qytetarët shqiparë të cilëve iu kishte mbaruar afati i pashaportës dhe ID.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka raportuar përmes komunikimit elektronik lidhur me përditësimin e numrit të aplikimeve të realizuara nga shërbimet konsullore jashtë vendit. Në periudhën janar - maj 2022 janë realizuar gjithsej nga shërbimet konsullore jashtë: Kartë ID + Pasaportë: 44,593/ veprime të tjera konsullore: 27,807

NË PROCES

### | Masa Nr.8 |

Vendosja e koordinimit mbi bazën e një programi të miratuar të projekteve me donatorët ndërkombëtarë për realizimin e masave të Planit të Veprimit apo që mbulojnë interesat e diasporës shqiptare.

**INDIKATORËT :** Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse në aplikimin për projekte kushtuar diasporës me donatorët kombëtarë dhe ndërkombëtare.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën

## Janar-Mars 2021:

- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Zyrës së Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në Tiranë “Për konsultim në çështjet me interes të përbashkët”. Marrëveshja parashikon konsultimin dhe bashkëveprimin për çështjet me interes të përbashkët dhe zhvillimin e aktiviteteve edhe në lidhje me zbatimin e Programit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë”.
- Është në proces zbatimi i Projektit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë”, i cili financohet nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS) dhe zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM). Projekti ka si qëllim të forcojë angazhimin dhe rritjen e kontributit të komuniteteve shqiptare jashtë vendit për zhvillimin e shtetit shqiptar përmes transferimit të dijeve dhe aftësive ekonomike.
- Në zbatim të Projektit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë”, i cili financohet nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS) është Programi “Connect Albania” (CA). Ky Program është një projekt

inovator për rritjen e investimeve me ndërmjetësimin e diasporës. Prezantimi i Programit "Connect Albania" po implementohet fillimisht në Republikën e Italisë për të vazhduar më pas edhe me shtete të tjera. Në funksion të implementimit të këtij programi, janë zhvilluar tre takime online, me qëllimin për të krijuar një mekanizëm që t'i shërbejë forcimit të lidhjeve të Diasporës për të nxitur investimet e huaja në Shqipëri. Ky proces do të fillojë duke inkurajuar angazhimin në rritjen e investimeve nga kompanitë italiane në Shqipëri. Takimet on-line janë zhvilluar në datat 15 Janar, 5 shkurt dhe 12 mars 2021. Ato janë realizuar me pjesëmarrjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën; Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësues nga Zyra IOM në Shqipëri; përfaqësues të tjerë nga institucionet e Diasporës; përfaqësues nga Programi në Agjencinë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim në Tiranë, Zyra e Connect Albania si dhe përfaqësues të interesuar nga shoqëria civile.

- Në datë 08.03.2021, në kuadër të programit "Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë" janë prezantuar 35 (tridhjetë e pesë) ekspertë që jetojnë në vende të ndryshme jashtë Shqipërisë si pjesë e diasporës shqiptare, të cilët do të angazhohen në prioritetet negociuse të integritimit evropian dhe vlerësimeve sektoriale të Shqipërisë. Ky Projekt zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, IOM Albania në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe ministri të tjera të linjës, dhe në koordinim me Ambasadën e Republikës së Italisë në Tiranë dhe Agjencinë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor.
- Më datë 21.01.2021 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit midis GIZ Albania dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për përmirësimin e "Rrjetit të Profesionistëve" dhe zhvillimin e mirëmbajtjes së moduleve të reja të këtij rrjeti. "Rrjeti i profesionistëve të Diasporës" është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet e profesioneve të ndryshme në diasporë. Qëllimi i Platformës është të mbledhë dhe të shkëmbejë informacione dhe përfshirjen e ekspertizës së anëtarëve të këtyre komuniteteve shqiptare në diasporë dhe t'i lidhë ato edhe me kërkesat e biznesit shqiptar apo të huaj me focus zhvillimin e vendit. Ai synon në një fazë të dytë të shërbejë në gjenerimin e ideve dhe nismave nga komunitetet profesionale të diasporës shqiptare. Ky rrjet është një platformë ku profesionistët shqiptarë komunikojnë në nivel profesional me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave.
- Në partneritet me Shoqatën e Kultivuesve Italianë (ACI), Dhoma e Biznesit të Diasporës po zbaton Projektin "Angazhimi i diasporës në transferimin e njohurive bujqësore në Shqipëri". Ky projekt synon përfshirjen konkrete të diasporës shqiptare në Itali në promovimin e shërbimeve dhe produkteve bujqësore në Shqipëri, rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimin e njohurive, teknikave dhe praktikave moderne të testuara, përdorimin e instrumenteve të miratuara nga Bashkimi Evropian në mbrojtje të biodiversitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në bujqësi brenda kuadrit të Marrëveshjes së Gjelbër. Me anë të këtij projekti Dhoma e Biznesit të Diasporës do të nxisë transferimin e njohurive në bujqësi nga diaspora shqiptare, (kryesisht ajo në Itali), drejt sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme bujqësore në Shqipëri në zonat rurale të Kavajës, Durrësit dhe Përmetit. Kontrata është nënshkruar në datën 01.03.2021 me Dhomën e Biznesit për Diasporën.
- Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare filloi zbatimin e Projektit "Rrënjët e mia-Kulturë 360", i cili është bashkëfinancim i Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë. Ky projekt synon të promovojë trashëgiminë kulturore shqiptare



nëpërmjet dimensioneve të reja të komunikimit dhe prezantimit që ofron teknologjia e informacionit. Aktivitetet e Projektit kanë si qëllim të minimizojnë distancat e krijuara në kushtet e pandemisë Covid-19, të gjallërojë krijimtarinë artistike, kryesisht atë tradicionale, të krijojnë një mjedis promovues dhe bashkëpunimi aktiv midis bizneseve të artizanatit vendas dhe atyre në diasporë, të evidentojnë fuqinë e artizanatit shqiptar për të sfiduar kohën dhe ruajtur origjinalitetin pavarësisht rrethanave si edhe të nxisin përfshirjen e brezave të rinj në kultivimin dhe ruajtjen e vlerave tradicionale të origjinës së tyre përtej kufijve gjeografikë.

- Qendra e Botimeve për Diasporën ka aplikuar për projektin me titull “Abroad but Boosting my Albanian - ABBA” në programin “Ongoing Funding Opportunity Program” në Ambasadën Amerikane. Projekti me titull “Abroad but Boosting my Albanian - ABBA” synon të zgjidhë dy probleme, të cilat lidhen me mësimdhënien në diasporë: -
  - Së pari, mungesën e aftësive digjitale të mësuesve për të vepruar në përputhje me kërkesat e mësimdhënies online dhe në përputhje me masat paraprake të diktuar nga pandemia Covid-19.
  - Së dyti projekti synon të zgjidhë rritjen e numrit të ulët të regjistrimit në shkollat shqiptare të gjuhës në diasporë (5% e fëmijëve shqiptarë), duke shmangur kështu rrezikun e asimilimit të brezit të dytë e të tretë të shqiptarëve jashtë vendit.

### **Prill-Qershor 2021:**

- Me shkresën nr. 737 Prot., datë 08.02.2021 “Kërkesë për informacion mbi projektet me financim të huaj” në kuadër të programit efektiv dhe strategjik të asistencës së huaj në Shqipëri, Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon bashkëpunimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën për përditësimin e të dhënave për projektet me financim të huaj. Ministri i Shtetit për Diasporën ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 737/1 Prot., datë 01.03.2021 “Dhënie informacioni mbi projektet me financim të huaj” drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ministri i Shtetit për Diasporës, sipas shkresës informon bashkëpunimet e huaja si më poshtë:
  - Projekti “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë”. Projekti financohet nga Bashkëpunimi Italian me përfshirjen operacionale Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS) dhe zbatohet nga zyra në Tiranë e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Ky projekt ka si qëllim të kontribuojë për të forcuar angazhimin dhe rritjen e komuniteteve shqiptare jashtë vendit për zhvillimin e shtetit shqiptar përmes transferimin atje të dijeve dhe aftësive ekonomike.
  - Projekti i “Gazeta e Diasporës Shqiptare”. Është bashkëpunim i Ambasadës së Konfederatës Zviceriane dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Ky projekt ka për qëllim informimin dhe krijimin e lidhjeve të informacionit midis komuniteteve shqiptare në Diasporë dhe Shqipërisë.
  - Projekti “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”. Platforma Rrjeti i profesionistëve në Diasporë vjen si produkt i projektit Diaspora për Zhvillim. Platforma është krijuar me qëllimin madhor të hartëzimit të profesionistëve shqiptarë në Diasporë. Ajo u vjen në ndihmë anëtarëve të Diasporës duke iu ofruar mundësinë për të kapërcyer barrierat gjeografike, për të lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin ndërmjet

tyre. Platforma Rrjeti i Profesionistëve i ofron përdoruesve profesionistë shqiptarë në Diasporë mundësi informimi, mundësi bashkëpunimi, mundësi punësimi, investimi etj.

- Ministri i Shtetit për Diasporën me shkresën nr. 1720 Prot., datë 31.03.2021 ka përcjellë mbështetjen e projekt propozimit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët “Ndërtimi i bazës kërkimore funksionale në Shqipëri për gjuhët e rrezikuara”.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar përmes komunikimit elektronik në lidhje me prezantimin e Programit Connect Albania, i cili po implementohet fillimisht me Italinë. Për këtë qëllim janë mbajtur 3 takime on-line, me përfaqësues të IOM, MEPJ, MSHD, dhe përfaqësues të tjerë nga shoqëria civile, për ta bërë këtë mekanizëm t’i shërbejë forcimit të këtyre lidhjeve të Diasporës me Shqipërinë, duke inkurajuar angazhimin dhe përfshirjen e tyre për rritjen e investimeve nga kompanitë italiane në Shqipëri duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka informuar përmes komunikimit elektronik lidhur me Marrëveshjen e zbatimit me GIZ Albania për projektin “Këshillimi për Migracionin në Shqipëri”. Objektivi i këtij projekti ishte lufta kundër migracionit të parregullt, duke ofruar informacion për rrugët e ligjshme të migracionit të punës dhe duke informuar për arsimin dhe formimin profesional, si dhe perspektivat e tregut të punës në Gjermani dhe në Shqipëri. Ky projekt ka vazhduar të zbatohet gjatë vitit 2020 dhe në fillim të vitit 2021 nga GIZ Albania është propozuar teksti i një marrëveshje të re për çështjet migratore duke vazhduar bashkëpunimin e vendosur në këtë drejtim.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka dakordësuar me Platformën Digjitale të Mësimdhënies “SchoolMe” krijimin e një seksioni të ri, të quajtur “ Mëso Shqip”, e cila do t’i dedikohet mësimin të gjuhës shqipe në Diasporë. Seksioni “Mëso Shqip” me materialet ndihmëse për mësimdhënien në Diasporë do të jetë gati për vitin e ri shkollor 2021-2022 në muajin shtator.

### **Korrik-Dhjetor 2021:**

Zbatimi i masës nr.8 lidhet me 6 muajin e parë të vitit 2021, megjithatë informacion plotësues pasqyrohet dhe për periudhën korrik-dhjetor 2021.

- Është zhvilluar aktiviteti final “Open Doors for Diaspora” në datë 14 dhjetor 2021, në kuadër të Programit “Angazhimi i Diasporës shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë”, bashkëpunim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin IOM, si dhe mekanizmi “Connect Albania”, financim i Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor me mbështetjen e Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme, zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM Albania).
- Projekti “Gazeta e Diasporës Shqiptare” lidhet me informimin dhe krijimin e lidhjeve të informacionit midis komuniteteve shqiptare në Diasporë dhe Shqipërisë. Ky projekt ka për qëllim informimin dhe krijimin e lidhjeve të informacionit midis komuniteteve shqiptare në Diasporë dhe Shqipërisë.

- Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, funksionon platforma “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”, e cila është krijuar me qëllimin hartëzimin e profesionistëve shqiptarë në Diasporë. Ajo u vjen në ndihmë anëtarëve të Diasporës duke iu ofruar mundësinë për të kapërcyer barrierat gjeografike, për të lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin ndërmjet tyre. Platforma Rrjeti i Profesionistëve i ofron përdoruesve profesionistë shqiptarë në Diasporë mundësi informimi, mundësi bashkëpunimi, mundësi punësimi, investimi etj.
- Programi Connect Albania (CA) është një program inovator online për rritjen e investimeve të krijuar në kuadrin e Projektit IOM Albania “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë”. Connect Albania lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si Agjentë Zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet e mundshme midis komunitetit shqiptar dhe komuniteteve të huaja përmes këtij mekanizmi. Agjentët e Zhvillimit shërbejnë si ndërmjetës /ura/ lidhje ndërmjet Zyrës së Programit dhe investitorëve /bizneseve të huaja në Shqipëri. Gjatë vitit 2021, janë angazhuar 20 (njëzetë) Agjentë Zhvillimi të certifikuar.

### Korrik-Dhjetor 2022:

- Qendra e Botimeve për Diasporën informon mbi projektin për organizimin “Ditët e librit Arbëresh”, në bashkëpunim me FAA-në si dhe me shoqata apo individë studiues në këtë kuadër.
- Qendra e Botimeve për Diasporën informon fillimin e vënies në praktikë të projektit të “Shtëpisë së Arbëreshëve”, një projekt që është skicuar që në fillim të krijimit të QSPA-së në kuadrin e strategjisë gjithpërfshirëse të trashëgimisë arbëreshe në një vend. Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët krahas studimit e botimeve të kulturës retrospektive e aktuale, i jep rëndësi parësore në vizionin e vet arkivimit, ruatjes, shfrytëzimit të kësaj trashëgimie dokumentare të dorëshkrimeve, librave, por edhe asaj fotografike, audiovizive e sonore digjitale brenda territorit të Shqipërisë. Ngritjen e Arkivit të Arbëreshëve.

NË PROCES

### **Masa Nr.9**

Vlerësimi i akteve të brendshme ligjore dhe marrëveshjeve në fushën e migracionit për zgjerimin e mbrojtjes së interesave të komuniteteve shqiptare jashtë vendit në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ai do të ketë qëllim përafrimin e tyre me Acquis Communautaire dhe realizimin e procedurave për përfundimin e ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare në këtë fushë (nëse nuk janë realizuar ende).

**INDIKATORËT :** Realizimi i një takimi vjetor për rivlerësimin e akteve ligjore ekzistuese në fushën e migracionit dhe zbatimin e procedurave për ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare.

## **AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)**

### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**
- **Ministria e Drejtësisë**
- **Ministria e Brendshme**

### **Korrik-Dhjetor 2021:**

- Më 13 dhjetor 2021 është realizuar një takim vjetor gjatë të cilit është diskutuar dhe për rivlerësimin e akteve ligjore ekzistuese në fushën e migracionit dhe zbatimin e procedurave të ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare.
- Është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën për Vlerësimin dhe Promovimin e Artit dhe Kulturës në Diasporën Shqiptare. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është krijimi i modelit të bashkëpunimit, midis institucioneve të varësisë të Ministrisë së Kulturës dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës, me qëllim vlerësimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të artit dhe kulturës të pjesëtarëve të diasporës, ruajtjen e traditave kombëtare kulturore, si dhe nxitjen e shtrirjes së tyre.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Komiteti Olimpik Shqiptar, kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, për promovimin, nxitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive të pjesëtarëve të diasporës, me synim ruajtjen e traditave sportive kombëtare kulturore si dhe promovimin e shtrirjes së tyre, në datë 7.7.2021.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Instituti Alb-Shkenca kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për nxitjen e kërkim - zhvillimit dhe të bashkëpunimit me diasporën shkencore shqiptare, në datë 16.09.2021.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Bashkia Tiranë kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me qëllim promovimin e pjesëtarëve të diasporës dhe bashkërendimin për çështje të lidhura me diasporën, në datë 18 Tetor 2021.

### **Korrik-Dhjetor 2022:**

- Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe shoqëria e akademikëve shqiptare - Dija e.V.me qëllim rrjetëzimin dhe nxitjen e bashkëpunimit me diasporën shkencore kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi në datë 21.11.2022.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me qëllim bashkërendimin e çështjeve dhe eventeve në kuadër të rrjetëzimit të përbashkët në diasporë, në datë 9.12.2022.

### **Korrik-Dhjetor 2022:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme informon trajtimin në çdo takim me përfaqësuesit e shteteve të tjera për diskutimin e marrëveshjeve për sigurimet shoqërore për shtetasit shqiptar që jetojnë dhe punojnë jashtë.

Shqipëria ka 12 marrëveshje të nënshkuara për Mbrojtjen Sociale, po negocion 11, ka

iniciuar 9 të reja, po vlerëson 2 dhe ka të ngrira 2.

Janë 12 Marrëveshje Bilaterale të nënshkruara për Mbrojtjen Sociale Austri, Belgjik, Ceki, Gjermani, Hungari, Kanada, Kosovë, Luksemburg, Maqedoni e Veriut, Rumani, Turqi, Zvicër . (Kanada ka hyrë në fuqi më 1 gusht 2022 dhe Kosova ka hyre ne fuqi ne 20 qershor 2022)

Janë 11 Marrëveshje në proces negocimi:

Arabi Saudite , Bullgari , EBA, Greqi , Holandë, Itali , Kroaci, Mali i Zi, Poloni, Serbi, Spanjë.

Është tregtuar interes për negocimin me 9 vende:

Australi, Danimarkë, Francë, Mbretëri e Bashkuar , Vendet Nordike (4- Suedi, Norvegji, Islandë, Finlandë), SHBA.

Janë në proces vlerësimi marrëveshjet me 2 vende:

Moldavi , Slloveni.

Mbeten të ngrira 2 marrëveshje:

Indi, Izrael

### Janar-Qershor 2023

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë informon:

Marrëveshjet për njohje dhe konvertim të lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit janë në fuqi me Italinë, Maqedoninë e Veriut, Kroacinë, Malin e Zi, Kosovën, Greqinë, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Gjermaninë. Marrëveshjet për njohje dhe konvertim të lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit janë në proces me Turqinë, Bosnje dhe Hercegovinën dhe Arabinë Saudite, Spanjën, Moldavinë, Francën, Katarin dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Belgjika e njeh dhe e konverton lejedrejtimin Shqiptar, konvertime të lejedrejtimit shqiptar kryen edhe Austria, Rumania, Bullgaria, Çekia, Sllovenia, Polonia.

Shtetet që kanë kërkuar plotësim formulari për aplikim për njohjen e lejeve të drejtimit, të cilëve ju është kthyer përgjigje janë Danimarka, Spanja, Rusia, Holanda dhe Moldavia.

Marrëveshje me reciprocitet ka me Republikën e Koresë.

NË PROCES

### | Masa Nr.10 |

Krijimi dhe vijueshmëria e strukturave informuese për orientimin e qytetarëve shqiptarë jashtë vendit në përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike të cilat ofrohen nga përfaqësitë shqiptare (platforma online). Dhënia e informacionit rreth organizatave jo qeveritare të akredituara nga shteti pritës, të cilat ofrojnë asistencë dhe mbrojtje ligjore për komunitetet e huaja.

**INDIKATORËT:** Informim periodik i Komitetit Shtetëror të Diasporës për gjendjen e orientimi i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit për shërbimet nëpërmjet platformës konsullore online dhe organizim komunikimi me shoqërinë civile në shtetin pritës. Organizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)**

## INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Drejtësisë
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

### Janar-Mars 2021:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar përmes komunikimit elektronik lidhur me shërbimet e reja konsullore online që kanë të bëjnë me çështje të migracionit dhe diasporës, të cilat vijojnë si më poshtë:

- Janë shtuar zyrat konsullore për aplikime për pasaporta biometrike (PP) dhe letërnjoftime (ID) pranë Ambasadave Shqiptare në Vjenë, Austri, Paris, Francë; në Berlin, Gjermani; në Stokholm, Suedi; si dhe pranë Konsullatave në Bari për Italinë, Stamboll për Turqinë, duke e çuar në 14 (katërmëdhjetë) numrin total të zyrave të aplikimit në mbarë botën.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme përdor një sërë kanalesh komunikimi për informimin e diasporës dhe publikun e gjerë. Drejtoria e Diplomacisë Publike dhe Diasporës përdorë faqen zyrtare të Ministrisë së Evropës dhe Punët e Jashtme. Përfaqësitë diplomatike përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme komunikimin në faqet përkatëse si edhe rrjetet sociale për informimin e publikut lidhur me shërbime konsullore si dhe regjimit të lëvizjes së njerëzve në kushtet e pandemisë.
- Është mundësuar ofrimi i shërbimeve në vendbanimet e tyre për shtetasit me aftësi të kufizuara.
- Është mundësuar implementimi i firmës digjitale, projekt i cili nisi zbatimin pas miratimit të Ligjit Nr. 22/2021, datë 22.02.2021 “Për miratimin e shtesës së kontratës për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave biometrike”. Shtimi i shërbimit të transmetimit të të dhënave të shtetasve online, përmirëson procesin e punës, shkurton ndjeshëm kohën e pajisjes me dokumente biometrike. Është arritur që nëpërmjet sistemit shtetasit që aplikojnë për Pasaporta biometrike dhe karta ID të caktojnë vetë datën dhe orën e takimit. Në periudhën janar-maj 2021 janë realizuar gjithsej nga shërbimet konsullore jashtë vendit: Kartë ID + pasaportë: 62377, Veprime të tjera konsullore: 24108.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka shtuar një adresë të dedikuar për shërbimet konsullore online shko@mfa.gov.al, ku çdo shtetasi i kthehet përgjigje brenda ditës sipas kërkesës për të cilin është i interesuar.
- Në lidhje me marrëveshjen me Italinë për njohjen e patentave shqiptare, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, informon në mënyrë periodike në rrjetet sociale të saj dhe të Përfaqësive Diplommatike të Shërbimeve Konsullore në lidhje me çështje si:
  - Protokollet e lëvizjes gjatë pandemisë;
  - Regjimin e vizave për qytetarët shqiptarë që duan udhëtojnë në vende të ndryshme të botës me dokumente shqiptare;
  - Mundësi punësimi apo shpallje të projekteve të ndryshme.
  - Është mundësuar ofrimi i shërbimeve në vendbanimet e shtetasve me aftësi të

kufizuar.

### **Prill-Qershor 2021:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar përmes komunikimit elektronik lidhur me përditësimin e numrit të aplikimeve të realizuara nga shërbimet konsullore jashtë vendit. Është arritur që nëpërmjet sistemit shtetasit që aplikojnë për Pasaporta biometrike dhe karta ID të caktojnë vetë datën dhe orën e takimit. Në periudhën janar - qershor 2021 janë realizuar gjithsej nga shërbimet konsullore jashtë vendit: Kartë ID + Pasaportë: 76 459, Veprime të tjera konsullore: 29908.

### **Korrik-Dhjetor 2021:**

Zbatimi i masës nr.10 lidhet me 6 mujorin e parë të vitit 2021, informacion plotësues pasqyrohet dhe për periudhën korrik-dhjetor 2021.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar përmes komunikimit elektronik lidhur me përditësimin e numrit të aplikimeve të realizuara nga shërbimet konsullore jashtë vendit. Në periudhën qershor - dhjetor 2021 janë realizuar gjithsej nga shërbimet tona konsullore jashtë: Kartë ID + Pasaportë: 65.983, veprime të tjera konsullore: 48.077
- MEPJ dhe përfaqësitë diplomatike informojnë periodikisht për: protokollet e lëvizjes gjatë pandemisë, regjimin e vizave për qytetarët shqiptarë që duan të udhëtojnë në vende të ndryshme të botës, mundësi punësimi apo të projekteve të ndryshme.
- Përveç shtimit të zyrave konsullore për aplikime për pasaporta dhe ID, MEPJ në bashkëpunim me Ambasadën Shqiptare në Athinë dhe autoritetet greke, mundësoi shërbime në ishujt Rodos dhe Kretë për të gjithë qytetarët shqiptarë të cilëve iu kishte mbaruar afati i pashaportës dhe ID.

### **Korrik-Dhjetor 2022**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar përmes komunikimit elektronik lidhur me përditësimin e informacionit që përfaqësitë diplomatike informojnë periodikisht në faqet dhe rrjetet e tyre sociale për protokollet e lëvizjes, regjimin e vizave për qytetarët shqiptarë që duan të udhëtojnë në vende të ndryshme të botës, shërbimet e reja të platformës e-albania, shërbimet konsullore, mundësi punësimi apo të projekteve të ndryshme.
- Në periudhën qershor-dhjetor 2022 janë realizuar gjithsej nga shërbimet tona konsullore jashtë:
- Kartë ID + Pasaportë: 47,595 veprime të tjera konsullore: 51,996.

NË PROCES

**Masa Nr. 11**

Vlerësimi dhe zgjerimi i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes civile dhe bazave të të dhënave me të dhëna për migrantët dhe rishikim periodik i bazës ligjore për regjistrimin e migrantëve. Përcaktimi i përgjegjësive dhe të dhënave që duhen mbledhur si edhe identifikimi dhe planifikimi i krijimit të rrjetit dhe infrastrukturës së duhur. Organizimi i

aktiviteteve publike dhe shoqërinë civile mbi qëllimin e sistemit të regjistrimit dhe votimit të shtetasve jashtë vendit.

**INDIKATORËT :** Zgjerimi i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes civile me të dhëna për migrantët dhe organizimi i aktiviteteve jashtë vendit. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR:** 6 maji i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Brendshme

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Ministria e Brendshme është angazhuar gjatë vitit 2021 për saktësimin e adresave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Kjo realizohet përmes portalit e-albania, nëpërmjet të cilit, shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit, deklarojnë adresën e tyre dhe ngarkojnë një dokument mbështetës së deklaratës. Kjo deklaratë procesohet nga nëpunësi i Gjendjes Civile përkatëse, i cili përditëson adresën e shtetasit që jeton jashtë Shqipërisë. Në këtë mënyrë të dhënat në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile saktësohen në kohë reale, mbi baza ditore me deklaratimet e përcjella për këtë qëllim.

NË PROCES

**Masa Nr.12**

Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse të diasporës në bashkëpunim me shtetin e Kosovës në shërbim të ruajtjes së identitetit kombëtar dhe për të ofruar shërbime e informacion për komunitetet e shqiptarëve në diasporë.

**INDIKATORËT :** Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse në bashkëpunim me shtetin e Kosovës. Realizimi i programimit buxhetor.

**AFATI KOHOR:** 6 maji i dytë 2022

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Financës dhe Ekonomisë
- Ministria e Kulturës
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

**Korrik-Dhjetor 2022:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme informon se Ambasada e Republikës së



Shqipërisë në Greqi është në proces të zhvillimit të projektit “Për ngritjen e Qendrës Kulturore Shqiptare në Athinë” e cila do të shërbejë si vatër për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit, të gjuhës shqipe dhe trashëgimisë kulturore kombëtare.

NË PROCES

### **Masa Nr. 13**

Organizimi i një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit dhe të nëpunësve në administratë të specializuar në institucionet të cilat merren me politikën e Diasporës dhe Migracionit. (Plotësimi i rrjetit edhe me emrat dhe detajet e studiuesve dhe nëpunësve shtetërorë nga Agjencia Kombëtare e Diasporës).

**INDIKATORËT** : Krijimi dhe administrimi të një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit. Realizimi vjetor i një aktiviteti në nivel teknik.

**AFATI KOHOR:** 6 muhori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

**Janar-Qershor 2022:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme informon se ka bashkëpunuar me Organizatën “GERMIN” në Shqipëri, e cila është një organizatë joqeveritare që përdor teknologjinë dhe kanalet virtuale për të lidhur dhe angazhuar Diasporën në avancimin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendeve të tyre në kuadër të projektit më të ri “Original”.

NË PROCES

### **Masa Nr. 14**

Realizimi i trajnimeve të veçanta për fushën e migracionit me administratën shtetërore dhe lokale dhe realizimi i përfshirjes së tyre në programet e universiteteve shqiptare. Organizimi i trajnimeve periodike në fushën e legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar për nëpunësit që mbulojnë çështje të migracionit. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve që kanë nevojë për trajnime ligjore. Hartimi i moduleve trajnuese në këtë fushë dhe përfshirjen e një moduli të tillë në trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil.

**INDIKATORËT** : Organizimi i trajnime të përgjithshme dhe të veçanta periodike. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve. Hartimi i moduleve trajnuese. Realizimi i një takimi vjetor në nivel teknik.

**AFATI KOHOR:** 6 muhori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

## INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

### Korrik-Dhjetor 2021:

- Është zhvilluar trajnimi me temë “Roli i Qeverisë në përfshirjen e diasporës për zhvillim”, organizuar nga GIZ Albania, nëpërmjet mbështetjes financiare të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për llogari të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (BMZ), në kuadër të zbatimit të programit “Migrim dhe Diaspora”, në datat 16-17 Nëntor 2021.

NË PROCES

### **Masa Nr. 15**

Hartimi i manualeve praktike që lidhen me çështjet e migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që merren me zbatimin në praktikë të legjislacionit për Migracionin. Identifikimi i akteve ligjore/nënligjore që zbatohen në praktikë nga çdo institucion i cili mbulon çështje të caktuara të diasporës dhe migracionit. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë lidhur me legjislacionin migrator dhe në mënyrë të veçantë me të drejtat e komuniteteve shqiptare në diasporë.

**INDIKATORËT :** Hartimi i manualeve praktike me aktet ligjore/nënligjore. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë për çështjet e migracionit. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

## INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Drejtësisë

### Korrik-Dhjetor 2021:

- Në 13 dhjetor 2021 Grupi Drejtues për Migracionin, zhvilloi takimin e tij të parë ku u prezantuan Raportet Vjetore të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin (SKM) dhe Planit të Veprimit 2019-2022, përparat nga Sekretariati Teknik i Migracionit (STM) në Ministrinë e Brendshme si dhe rishikimi afatmesëm i Planit të Veprimit të Strategjisë. Ky takim shënoi një cikël të plotë të funksionimit të Mekanizmit Koordinues të Qeverisjes së Migracionit në Shqipëri.
- Ky proces është mbështetur nga IOM në Shqipëri, në kuadër të projektit “Përmirësimi i koordinimit për qeverisjen e migracionit në Shqipëri” i implementuar bashkërisht me GIZ Albania, nëpërmjet mbështetjes financiare të Deutsche Gesellschaft für

Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për llogari të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (BMZ).

- Kane vijuar zhvillimi i takimeve periodike të ekspertëve të MEPJ në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Migracionit.

NË PROCES

### **Masa Nr. 16**

Nxitja e bashkëpunimit shtetëror me institucionet e vendeve pritëse të cilat trajtojnë çështje të migrantëve, të drejtave të grave dhe të drejtave të fëmijëve. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative të nivelit të lartë me shtetet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare të diasporës dhe funksionimi i tyre në mënyrë periodike për këtë qëllim. Informimi publik për ecurinë dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie për publikun e interesuar.

**INDIKATORËT :** Bashkëpunim shtetëror me institucionet e vendeve pritëse. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative dhe informimi publik për ecurinë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Drejtësisë

**Janar-Qershor 2022:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka raportuar përmes komunikimit elektronik se është kryer trajtimi në çdo takim me përfaqësuesit e shteteve të tjera për diskutimin e marrëveshjeve për sigurimet shoqërore për shtetasit shqiptar që jetojnë dhe punojnë jashtë.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjithashtu ka raportuar se:

Shqipëria ka 12 (dymbëdhjetë) marrëveshje të nënshkruara në fushën e Mbrojtjes Sociale, është në proces negocimi 12, ka iniciuar 8 (tetë) marrëveshje të reja, po vlerëson 2 (dy) marrëveshje dhe do të mbajë të ngrira 2 (dy) marrëveshje.

NË PROCES

### **Masa Nr. 17**

Përgatitja dhe shpërndarja e informacionit (broshurave, fletëpalosje, faqe interneti, app në telefonat celularë etj.) që ju drejtohet komuniteteve shqiptare në diasporë, ku të jepet informacion në lidhje me statusin dhe të drejtat e tyre si edhe për shërbimet që ju ofrohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore si edhe nga shoqatat e migrantëve me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare.

**INDIKATORËT** : Shpërndarja e informacionit në lidhje me statusin të drejtat si edhe shërbimet që ju ofrohen komuniteteve shqiptare në shtetet pritëse. Realizimi i një takimi vjetor në nivel teknik

**AFATI KOHOR:** 6 mujsori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

**Janar-Qershor 2022:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe përfaqësitë diplomatike informojnë periodikisht në faqet dhe rrjetet e tyre sociale për protokollet e levizjes, regjimin e vizave për qytetarët shqiptarë që duan të udhëtojnë në vende të ndryshme të botës, shërbimet e reja të platformës e-albania, shërbimet kosnullore mundësi punësimi apo të projekteve të ndryshme.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në bashkëpunim me Ambasadën Shqiptare në Athinë dhe autoritetet greke, mundësoi shërbime në ishujt Rodos dhe Kretë për të gjithë qytetarët shqiptarë të cilëve iu kishte mbaruar afati i pashaportës dhe ID.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme raporton përmes komunikimit elektronik se në periudhën janar – maj 2022 janë realizuar gjithsej nga shërbimet konsullore jashtë: Kartë ID + Pasaportë: 44,593 dhe veprime të tjera konsullore: 27,807

“Gazeta e Diasporës Shqiptare- Projekti i krijuar me mbështetjen dhe bashkëpunimin e Ambasadës së Konfederatës Zviceriane dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, qëllimi i të cilës është informimi dhe krijimi i lidhjeve të informacionit midis komuniteteve shqiptare në Diasporë dhe Shqipërisë.

NË PROCES

**Masa Nr. 18**

Vendosja e kontakteve të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel, për të vlerësuar mundësitë e mbështetjes së politikës të mbrojtjes së komuniteteve të shqiptarëve në diasporë në vendet pritëse të BE-së.

**INDIKATORËT** : Kontakte të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit.

**AFATI KOHOR:** 6 mujsori i dytë 2021

## INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Agjencia Kombëtare e Diasporës
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Brendshme

### Korrik-Dhjetor 2021:

- Agjencia Kombëtare e Diasporës është në proces komunikimi elektronik për vendosjen e komunikimit me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel. Për këtë qëllim është zhvilluar komunikim nëpërmjet mjeteve elektronike ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Znj.Graziana Galati, përfaqësuese nga Regione Emilia Romagna.

NË PROCES

### **Masa Nr.19**

Nxitja dhe intensifikimi i komunikimeve ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase për mbrojtjen e migrantëve. Identifikimi i organizatave në vendet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve në këto vende. Ndërgjegjësim nëpërmjet informacioneve në internet, tryezave dhe takimeve për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore në vendet pritëse dhe të origjinës.

**INDIKATORËT :** Realizimi i komunikimeve ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)**

## INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Agjencia Kombëtare e Diasporës
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Drejtësisë

### Korrik-Dhjetor 2021:

- Agjencia Kombëtare e Diasporës informon që është kryer identifikimi i shoqatave dhe organizatave në vendet pritëse dhe të dhënat janë bërë të aksesueshme në faqen zyrtare të Agjencisë.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës në datë 6 Tetor 2021, realizoi takim me shoqatat shqiptare në Greqi ku u diskutua mbi programe dhe projekte të përbashkëta që fuqizojnë rolin e diasporës shqiptare në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të vendit, si dhe njohja nga afër mbi problematikat dhe kërkesat e të gjitha shoqatave të pranishme. Takimet u zhvilluan në kuadër të programit “Ditët e Shqipërisë” të Agjencisë Kombëtare të Diasporës me komunitetin shqiptar në Greqi.

- Agjencia Kombëtare e Diasporës në datë 13 Nëntor 2021 realizoi takim me shoqatat shqiptare në Mbretërinë e Bashkuar, me qëllim ruajtjen dhe mësimin e gjuhës shqipe dhe trashëgimisë kulturore në komunitetin shqiptar në Londër.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës në datat 29 dhe 30 nëntor 2021, realizoi takim me shoqatat shqiptare në Turqi përfaqësuese të të drejtave dhe interesave të ligjshëm të pjesëtarëve të komunitetit shqiptar në Turqi. Gjatë takimeve u diskutua mbi programe dhe projekte të përbashkëta që fuqizojnë rolin e diasporës shqiptare në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të vendit dhe në veçanti shoqatat që kanë në mision e tyre fuqizimin e rolit të gruas në diasporë, apo mësimin dhe ruajtjen e gjuhës shqipe.
- Qendra e Botimeve për Diasporën organizoi në nëntor dy seminare të rëndësishme mbi mësimdhënien e gjuhës shqipe në diasporë në Bolonja të Italisë, mbi bazën e një programi të përbashkët hartuar nga Lidhja e Mësuesve Shqiptarë në Itali, Qendra e Botimeve për Diasporën si dhe Konsullata e Shqipërisë në Milano. Aktivitetet shërbyen dhe si një vend takimi mes institucioneve shtetërore të Italisë, Shqipërisë, Kosovës dhe mësuesve dhe nxënësve të komunitetit shqiptar, me qëllim evidentimin e problematikave dhe nevojave aktuale të mësuesve dhe adresimit të tyre për zgjidhje.
- Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshet informon, se janë zhvilluar aktivitete të ndryshme të përfaqësive shqiptare në botë me diasporën dhe shoqatat shqiptare të cilat u intensifikuan gjatë muajit nëntor me rastin e festave kombëtare. Këto aktivitete përfshijnë takime, koncerte, panairë, aktivitete kulturore, sociale, arsimore, ekonomike etj.

### Korrik-Dhjetor 2022:

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshet informon, se janë zhvilluar aktivitete të ndryshme të përfaqësive shqiptare në botë me diasporën dhe shoqatat shqiptare.

NË PROCES

### **| Masa Nr.20 |**

Rivlerësimi periodik i politikës së shërbimeve, procedurave dhe tarifave të tyre. Në bazë të informacioneve të marra nga përfaqësitë dhe hartimi nga Agjencia Kombëtare e Diasporës e një raporti vjetor për gjendjen konkrete të komuniteteve shqiptare në diasporë shoqëruar me propozime masash për përmirësimin e asistencës për ta. Raporti do të diskutohet në Komitetin Shtetëror të Diasporës.

**INDIKATORËT :** Rivlerësim i politikës së shërbimeve dhe hartimi i një raporti vjetor. Raportim në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)**

## INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Drejtësisë

### Janar-Qershor 2022:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe përfaqësitë diplomatike informojnë periodikisht në faqet dhe rrjetet e tyre sociale për protokollat e levizjes, regjimin e vizave për qytetarët shqiptarë që duan të udhëtojnë në vende të ndryshme të botës, shërbimet e reja të platformës e-albania, shërbimet kosnullore mundësi punësimi apo të projekteve të ndryshme.

NË PROCES

### **Masa Nr.21**

Negocimi për të nënshkruar marrëveshjet dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet pritëse me qëllim që ata të transferojnë sigurimet shoqërore edhe në Shqipëri. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore dhe nëse duhet nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave. (Rivlerësimi i një plan-veprimi të veçantë për çështjen e pensioneve të migrantëve shqiptarë).

**INDIKATORËT :** Negocimi për marrëveshjet dypalëshe me vendet pritëse. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)**

## INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Drejtësisë

### Korrik-Dhjetor 2021:

- Deri tani janë lidhur me 11 (njëmbëdhjetë) vende marrëveshje për mbrojtjen sociale, që sigurojnë njohjen e ndërsjellë të kontributeve të sigurimeve shoqërore nga vendet nënshkruese, ndërkohë që të tjera janë në proces. Nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të tilla, shteti shqiptar garanton përfitimin e pensioneve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, duke plotësuar një nga detyrimet për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave ekonomike e shëndetësore për ta.

- Gjatë takimit të zhvilluar në datë 17 nëntor 2021, në Romë Itali ndërmjet Kryeministrit Shqiptar Z.Edi Rama dhe Kryeministrit Italian Z.Mario Draghi u diskutua në lidhje me përshtetimin e procesit të njohjes së pensioneve Itali -Shqipëri. Në ligjin Italian për Buxhetin e vitit 2022, është përfshirë një fond specifik për lidhjen dhe nënshkrimin e marrëveshjes për pensionet ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë informon:
  - Marrëveshjet për njohje dhe konvertim të lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit janë në fuqi me Italinë, Maqedoninë e Veriut, Kroacinë, Malin e Zi dhe Kosovën.
  - Marrëveshjet për njohje dhe konvertim të lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit janë në proces me Serbinë, Greqinë, Emiratet e Bashkuara Arabe, Turqinë, Bosnje dhe Hercegovinën dhe Arabinë Saudite.
  - Belgjika e njeh dhe e konverton lejedrejtimit Shqiptar, konvertime të lejedrejtimit shqiptar kryen edhe Austria, Rumania, Bullgaria, Çekia, Sllovenia, Polonia.
  - Shtetet që kanë kërkuar plotësim formulari për aplikim për njohjen e lejeve të drejtimit, të cilëve ju është kthyer përgjigje janë Danimarka, Spanja, Gjermania, Rusia, Holanda dhe Moldavia.

### Janar-Qershor 2022:

Shqipëria ka 12 (dymbëdhjetë) marrëveshje të nënshkruara për Mbrojtjen Sociale, po negocion 12 (dymbëdhjetë) marrëveshje, ka iniciuar 8 (tetë) marrëveshje të reja, po vlerëson 2 (dy) marrëveshje dhe do të mbajë të ngrira 2 (dy) marrëveshje.

- ✓ Janë 12 (dymbëdhjetë) Marrëveshje Bilaterale të nënshkruara për Mbrojtjen Sociale: Austri, Belgjikë, Çeki, Gjermani, Hungari, Kanada, Kosovë, Luksemburg, Maqedoni e Veriut, Rumani, Turqi, Zvicër. (Kanada dhe Kosove hyjnë në fuqi gjatë viti 2022)
- ✓ Janë 12 (dymbëdhjetë) Marrëveshje në proces negociimi: Arabi Saudite, Bullgari, EBA, Greqi, Holandë, Itali, Kroaci, Mali i Zi, Poloni, Serbi, Spanjë, SHBA,
- ✓ Është tregtuar interes për negociimin e marrëveshjeve me 8 (tetë) vende: Australi, Danimarkë, Francë, Mbretëri e Bashkuar, Vendet Nordike (4- Suedi, Norvegji, Islandë, Finlandë).
- ✓ Janë në proces vlerësimi marrëveshjet me 2 (dy) vende: Moldavi, Slloveni.
- ✓ Mbeten të ngrira negociimi i 2 (dy) marrëveshjeve: Indi, Izrael.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë informon elektronikisht:

- Marrëveshja (Deklaratë e Angazhimit të Përbashkët), mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë Federale për Zhvillimin Digjital dhe Transportin të Republikës Federale të Gjermanisë, “Rreth çështjeve procedurale lidhur me konvertimin e lejeve të drejtimit të automjeteve”, nënshkruar në Tiranë më 12.04.2022 dhe ka hyrë në fuqi më 1.06.2022.
- Marrëveshje për njohje dhe konvertim të lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit në proces është nënshkruar marrëveshja me 7.03.2022, me Arabinë Saudite.



**Masa Nr.22**

Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit dhe organizimi i një takimi vjetor organizuar në bashkëpunim me zyrën e Avokatit të Popullit dhe organizatën e Kryqit të Kuq Shqiptar për këtë çështje. Diskutimi i vlerësimit të informacionit periodik dhe konkluzioneve për Komitetin Shtetëror të Diasporës.

**INDIKATORËT** : Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Drejtësisë

**Korrik-Dhjetor 2022:**

- Për zbatimin e Masës 22 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën korrik-dhjetor 2022.

**Masa Nr.23**

Organizimi dhe mbështetja e rrjeteve (edhe ndërkombëtare) të grupeve dhe shoqatave të veçanta të diasporës shqiptare në bazë të interesave, profesioneve të përbashkëta, apo vendndodhjes gjeografike. Krijimi i lehtësirave si p.sh.: botimi në gazeta, apo në faqe interneti e informacioneve që mundësojnë krijimin e grupeve profesionale dhe të interesave të përbashkëta. Ndërmjetësimi për vendosjen e kontakteve midis grupeve “homologe” në vende të ndryshme për të krijuar rrjete funksionale të kësaj natyre.

**INDIKATORËT** : Organizimi dhe mbështetja e grupeve dhe shoqatave të Krijimi i projekteve për realizimin e masës. Realizimi i një aktiviteti vjetor.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Janar-Qershor 2022:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme po mbështet grupe të interesit të shoqatave në Diasporë në lidhje me votimin në diasporë.

Në këtë kuadër është zhvilluar Konferenca Kombëtare: “Votimi nga jashtë vendit “Koha është tani”, në datë 24 maj 2022 me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm institucionalë, përfaqësi diplomatike, politike dhe nga shoqëria civile veçanërisht dhe të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Gjithashtu Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dha kontributin e saj në Takimin “Shqipëria në Kuvendim”, ku u diskutua mbi anketimin e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ku një nga temat kyçe ishte edhe votimi në Diasporë.

Agjencia Kombëtare e Diasporës informon se ka përditësuar në faqen zyrtare të saj listën e shoqatave shqiptare në diasporë dhe vijon komunikimin dhe bashkëpunimin me to.

Ministria e Kulturës informon se ndër projektet me thirrje të mbështetura financiarisht nga Ministria e Kulturës për vitin 2022, ka disa në të cilët janë përfitues, apo janë të ftuar të performojnë edhe artistë e krijues të talentuar dhe të suksesshëm, që veprojnë në Diasporë.

NË PROCES

#### **Masa Nr.24**

Mbështetja mbi bazën e projekteve të veçanta të organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese për shtetasit e huaj në qytetet ku migrantët shqiptarë janë të përqendruar, mbi bazën e udhëzuesit të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe Këshillit të Evropës.

**INDIKATORËT** : Mbështetja e organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR: 6 muji i parë 2023**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Drejtësisë

**Janar-Qershor 2023:**

Organizatave dhe shoqatat e diasporës përfaqësojnë zërin e anëtarëve të diasporës në vendet pritëse dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm në proceset strategjike vendimmarrëse në Shqipëri.

Në përgjithësi ata ruajnë lidhje të ngushta me vendlindjen, por angazhimi i tyre deri më tani është përqendruar kryesisht në aktivitete kulturore, arsimore dhe

humanitare. Sidoqoftë, organizatat e diasporës po përqendrohen gjithnjë e më shumë në potencialet e zhvillimit ekonomik.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka zhvilluar dhe konsoliduar bashkëpunimin institucional me organizatat dhe shoqatat e diasporës, për këtë qëllim janë nënshkruar përgjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023, Memorandume Bashkëpunimi midis:

- Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Shoqatës “Ardhmëria” në Londër Mbretëri e Bashkuar ;
- Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Shoqatës Kulturore Bashkimi Uster në Zvicër.

NË PROCES

### **Masa Nr.26**

Koordinimi dhe organizimi i takimeve apo “Ditëve të Shqipërisë” në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar edhe lehtësirat lidhur me investimet në Shqipëri.

**INDIKATORËT :** Koordinimi dhe organizimi i takimeve të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor. Realizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Kulturës
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Përfaqësitë shqiptare në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme kanë realizuar takime të parashikuara me komunitetet shqiptare në Diasporë gjatë cilave janë diskutuar çështje të ndryshme me të cilat ballafaqohet komuniteti shqiptar në vendet ku jetojnë dhe punojnë.
- Në kuadër të “Protokollit Zbatues për Bashkëpunim në Fushën e Diplomacisë Kulturore me Kosovën”, janë realizuar aktivitete të përbashkëta në Diasporë nga përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës, informon se me qëllim zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, përmirësimit të pozitës së diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saj, aty ku gjendet si dhe ofrimit të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare, gjatë periudhës Korrik - Dhjetor 2021, në kuadër të përmbushjes së programit vjetor “Ditët e Shqipërisë” ka

realizuar takime dhe aktivitete dedikuar komunitetit Arbëresh në Itali në datat 30 dhe 31 Gusht në Piana degli Albanesi Siçili dhe 1 Shtator 2021 në Cerzeto Kalabri, komunitetit Shqiptar në Greqi në datat 5-7 tetor 2021 dhe në kuadër të festave kombëtare të pavarsisë dhe flamurit 28 dhe 29 nëntor 2021 në Athinë, Komunitetin Shqiptar në Turqi në datat 29 dhe 30 nëntor 2021 dhe komunitetit Shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar në datë 12 dhe 13 Nëntor 2021, pranë komunitetit Shqiptar në New York në datat 3 deri 8 Dhjetor 2021.

NË PROCES

## **Masa Nr.27**

Koordinimi me institucionet shëndetësore, publike dhe private, në përgatitjen e një fushate për promovimin e turizmit shëndetësor, lidhur kryesisht me disa shërbime për të cilat Shqipëria ka siguruar avantazhe (dentar, neurokirurgji, kardiokirurgji etj.).

**INDIKATORËT :** Koordinimi me institucionet shëndetësore, publike dhe private, për promovimin e turizmit shëndetësor. Realizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**
- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**
- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**

**Janar-Qershor 2022:**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale informon përmes komunikimit elektronik se është duke punuar në drejtim të promovimit të turizmit shëndetësor.

Turizmi shëndetësor në Shqipëri ofron shërbime të kualifikuara shëndetësore në zonat turistike, panairë, për promovimin e ofertave shëndetësore, apo oferta për trajtime dhe diagnostikime në qendrat shqiptare për të gjithë turistët e huaj.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka inkurajuar institucionet shëndetësore si spitalet private, shoqatat dentare, bizneset e fushës së kirurgjisë plastike, e të turizmit të Fertilitetit, për të promovuar këtë lloj turizmi shëndetësor, duke marrë vetë iniciativën që të realizojë një marrëdhënie mes palëve, duke siguruar për çfarë ofrohet:

1. Cilësinë e lartë të shërbimit;
2. Koston e ulët;
3. Pajisje me teknologji të përparuara.
4. Nuk ka pritje e radhë të gjata.
5. Përvoja e gjatë e mjekëve, qoftë vendas dhe të huaj, si dhe metodat e avancuara të fertilizimit.

Pandemia Covid -19 pati ndikimin global në ekonomi duke prekur edhe mjaft biznese dhe padyshim duke ndikuar edhe në udhëtimet në shumë vende të botës. Industria e turizmit mjekësor ishte ndër më të goditurat, efektet e së cilës u shtrinë edhe në Shqipëri.

Por pavarësisht këtij fakti, turistët nga vendet fqinje, si Italia etj, kanë vijuar të udhëtojnë në Shqipëri për shërbime dentare.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pas rihapjes së territorit dhe lëvrimin të aktiviteteve ekonomike implementoi një strategji në kuadër të ringritjes dhe të përshtatjes me realitetin e ri, në fushatën e marketingut dhe promovimit.

Shumë prej guidave turistike që operojnë në Shqipëri ofrojnë paketa të turizmit dentar dhe turizmit shëndetësor, ku përveçse shërbimeve shëndetësore vizitojnë dhe vende turistike të Shqipërisë.

Trajtimet më të zakonshme janë kirurgji kozmetike, kirurgji dentare dhe ortopedike.

Në rritje janë kërkesat për kirurgji kardiovaskulare, operacione laparoskopike dhe trajtime për fertilitetin dhe obezitetin.

**-Koordinimi me institucionet shëndetësore, publike dhe private, për promovimin e turizmit shëndetësor. Realizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik.**

Gjithashtu, një vëmendje e veçantë i është kushtuar promovimit të vendit në panairët ndërkombëtare dhe në takimet bilaterale.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka marrë pjesë dhe në aktivitetet e organizuara nga Shoqatat e Profesionistëve të Diasporës, sikurse është AMFE (Albanian Medical Federation for Europe) në Danimarkë, Suedi, Bruksel, etj, në të cilat janë parashtruar dhe evidentuar mundësitë e turizmit shëndetësor në Shqipëri.

Gjithashtu, është zhvilluar Kongresi XII-të Europian i Mjekëve Shqiptarë të Diasporës, i organizuar nga AMFE (Albanian Medical Federation for Europe) në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM), në datë 3-4 qershor, në Tiranë. Në takim morën pjesë autoritete të larta shtetërore. Në këtë kongres u themelua edhe Dega e AMFE (Albanian Medical Federation for Europe) për Shqipërinë.

NË PROCES

## Masa Nr.28

Përfshirja e komunitetit të shqiptarëve të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës dhe në Shqipëri me qëllim promovimin e tyre (nënshkrimi dhe/ose amendimi i marrëveshjeve dypalëshe me shtetet pritëse të diasporës duke përfshirë edhe interesat e këtyre të fundit në to) dhe nxitja e krijimit të aktiviteteve vjetore për këtë qëllim.

**INDIKATORËT** : Komunitetet shqiptare të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës, me qëllim promovimin e tyre në Shqipëri. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria e Kulturës
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

### Korrik-Dhjetor 2021:

- Është zhvilluar konferenca e 25 me temë “Gjendja e arbërishtes dhe studimet mbi të, si gjuhë e rrezikuar e Diasporës”, organizuar nga Fondacioni për Gjuhët e Rrezikuara në bashkëpunim me QSPA dhe Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë.
- Është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën për Vlerësimin dhe Promovimin e Artit dhe Kulturës në Diasporën Shqiptare. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është krijimi i modelit të bashkëpunimit, midis institucioneve të varësisë të Ministrisë së Kulturës dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës, me qëllim vlerësimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të artit dhe kulturës të pjesëtarëve të diasporës, ruajtjen e traditave kombëtare kulturore, si dhe nxitjen e shtrirjes së tyre.

### Janar-Qershor 2022:

Ministria e Kulturës informon se ndër projektet me thirrje të mbështetura financiarisht nga Ministria e Kulturës për vitin 2022, ka disa në të cilët janë përfitues, apo janë të ftuar të performojnë edhe artistë e krijues të talentuar dhe të suksesshëm, që veprojnë në Diasporë.

Këtu mund të rendisim këto aktivitete që do të zhvillohen në 6 mujorin e parë të vitit 2022:

- 1.“Aulona International Folk Festival, edicioni 14-të” organizuar nga Qendra Kulturore “AULONA”;
- 2.Projekti “Na flet Asdreni” nga Prof. Josif Minga;
- 3.“Festivali i 17-të Ndërkombëtar i Muzikës së Dhomës, Durrës 2022” nga subjekti “Arti dhe kultura italo-shqiptare”;
- 4.“Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë nga shoqata “Shpirti artistik i Shkodrës”;
- 5.Projekti “International Jazz in Albania, Edicioni XI” (Festival) nga Shoqata “Syri Blu”;
- 6.“Festivali i 18-të Mbarëkombëtar i Instrumentistëve të Vegjël” nga “Shoqata Eko-Turistike Pukë”;
- 7.“Festivali Ndërkombëtar i Muzikës “Different Trains” nga shoqata “Different Trains”.

Ndërsa 10 projekte të tjera janë planifikuar për t’u zhvilluar 6 mujorin e dytë të këtij viti, të fituara nga pjesëtarë të Diasporës, të tillë si: Olen Cezari për projektin “Festivali Porto Palermo”, Suela Piciri për projektin “NGA SCALA NË TIRANË”, etj.

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale ka organizuar Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Këngës Popullore Qytetare, edicioni XVII-të, në qytetin e Elbasanit në datat 10-11 mars 2022. Në këtë aktivitet morën pjesë grupe nga Kavaja, Lushnja, Vlora, Kruja, Fieri, Lezha, Këlcyra, Elbasani, Shkodra, Berati dhe Ulqini, si dhe

përshëndetën ansambli “Egnatia” dhe ansambli i Këngëve dhe Valleve “Selman Kadria”, Istog, Kosovë (20 artistë).

Ndër projektet artistike me fokus në promovimin e artit dhe kulturës sonë kombëtare në arenën ndërkombëtare, duke mundësuar kështu edhe ndjekjen e tyre nga Diaspora në vendet përkatëse, mund të përmendim:

-Biennialja e Artit të Venecias, Edicioni i 59-të, titulluar “The Milk of Dreams” (Qumështi i Ëndrrave) do të mbahet në periudhën 23 Prill - 27 Nëntor 2022, në Venecia, Itali. Shqipëria do të përfaqësohet në këtë Biennale me pavionin shqiptar me titull “Lumturie Blloshmi, nga e para”, i cili do të kurohet nga Adela Demetja, e cila ka bashkëpunuar vitet e fundit me Blloshmin dhe synon të çojë në Venecia, frymën e artistes me forcë dhe provokim.

Lumturi Blloshmi ishte ndër të paktat artiste, e cila theu kornizat e kohës dhe nuk u përshtat kurrë me realizmin socialist. Prezantimi është konceptuar në tre pjesë krahas prezantimit të punëve emblematike dhe jetës së saj, e ripozicionuar në historinë e artit kombëtar dhe ndërkombëtar. Pavijoni shqiptar është i vendosur në harmoni me kuadrin politik, artistik dhe konceptual të “Qumështit të ëndrrave”, temës së Bienneses së Venecias.

-Panairi “Expo 2020 Dubai”, aktivitet me rëndësi për promovimin e vendit tonë si një destinacion turistik, nëpërmjet paraqitjes së bukurive natyrore, kulturës dhe traditës shqiptare. Në kuadër të organizimit të Ditës Kombëtare të Shqipërisë në këtë event të rëndësishëm botëror me prezencë të trupit diplomatik, investitorë, përfaqësues të politikës, etj., më 9 mars 2022, Ministria e Kulturës u prezantua me dy evente:

Eventi i parë ishte një program i paraqitur nga Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit dhe Ansambli Popullor, ku u ndërthurën aktivitetet me cilësi të lartë artistike, mes muzikës klasike dhe asaj tradicionale, të shoqëruar edhe me performancë skenike.

-Event tjetër ishte projekti “Etno Vibe Dubai - The future meets origin”, i menduar si ndërthurje e tradicionales me bashkëkohoren, ku përfshiheshin elemente si veshjet, muzika, kërcimi, etj. nga tre zona etnografike të Shqipërisë.

- Në kuadër të kalendarit të përbashkët kulturor Shqipëri-Kosovë janë realizuar disa shkëmbime kulturore. Kështu:

Në përkujtim të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, Ansambli “Shota” i Kosovës dhe Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Popullore i Shqipërisë dhanë koncerte me këngë e valle nga të gjitha trevat shqiptare.

Koncerti “Festë të madhe ka sot Kosova” u shfaq më 17 shkurt 2022, në sallën e Teatrit Kombëtar të Kosovës.

- Edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut është festuar 14 vjetori i Pavarësisë së Kosovës. Nën përkujdesjen e zëvendëskryeministrit të parë, Artan Grubi në Teatrin Shqiptar në Shkup, u organizua aktiviteti i titulluar “Dita e Plisit”, me pjesëmarrjen e Ansambli Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore të Shqipërisë, duke përcjellë një spektakël të vërtetë vlerash të trashëgimisë kulturore shqiptare.

- Gjithashtu, në përputhje me politikën për mbrojtjen dhe promovimin e prodhimeve filmike shqiptare në evente ndërkombëtare elitare, Ministria e Kulturës ka mbështetur fushatën promocionale për promovimin e filmit shqip “ZGJOI” (bashkëpunim Shqipëri-

Kosovë), përmes Shtëpisë Kinematografike “Albasky” Film, film i përzgjedhur në listën e shkurtër të konkurimit për cmimet OSCAR, në kategorinë “Filmi më i mirë ndërkombëtar”.

### Korrik-Dhjetor 2022:

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët informon se ka zhvilluar disa takime me përfaqësues të komunitetit Arbëresh në Itali, lidhur me strategjitë e bashkëpunimit në kuadër të ruajtjes dhe rijetëzimit të gjuhës dhe kulturës arbëreshe në shkolla, si dhe të realizimit të veprimtarive kulturore të përbashkëta.

### Janar-Qershor 2023:

Me vendimin e Kryesisë së Akademisë së Shkencave nr. 69, datë 13.12.2021 "Për krijimin e njësisë kërkimor-studimore për arbëreshët, arvanitët dhe arbneshët (më tej: NJKS-AAA), është ngritur njësi kërkimore studimore, me qëllim përqendrimin e dijes dhe rritjen e cilësisë e të profesionalizmit në këtë fushë veprimi të albanologjisë si dhe forcimin e perspektivës së tyre, ndërmjet ndërmarrjes dhe realizimit të projektve dhe studimeve të veçanta si:

- Organizimi i një konference kombëtare për miratimin e konventës/platformës së mësimin të arbërishtes dhe shqipes në shkolla, ndër arbëreshët (bashkë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit).
- Botimi i Vëllimi I deri Vëllimi III “Opera omnia” të Fr. A. Santorit.
- Përfundimi i fjalorit të arbërishtes së shkruar dhe të folur .
- Përfshirja e fjalorit arbëresh në Fjalorin e Madh të Gjuhës Shqipe.
- Botimi në italisht i “Barleti i rizbuluar”.
- Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

Ministria e Kulturës informon se më datë 16 Maj 2023 u mbajt konferenca për shtyp mbi, “Javët Kulturore Ndërkombëtare” në Shqipëri 2023, edicioni i dytë, që realizohet nën kujdesin e Ministrisë së Kulturës, në bashkëpunim me Ambasadat e Huaja të akredituara në Shqipëri, nismë e cila shërben si një mundësi njohjeje, bashkëpunimi, shkëmbimi mes artistëve dhe sigurisht pasurimin e jetës kulturore jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë Shqipërinë.

Në kuadër të realizimit të këtij projekti, për herë të parë përgjatë gjithë vitit kalendarik 2022, vendi ynë përjetoi një vit plot ngjarje kulturore, me pjesëmarrjen e artistëve ndërkombëtar. Më shumë se 1000 artistë pjesëmarrës nga 20 vende të botës, u ngjiten në skenë dhe performuan me artistët shqiptarë, nga ku përcollën për publikun dhe art dashësit, aktivitete të shumta të ndërthurura mes traditës, tingujve, imazheve, aromave dhe shijeve kulinare të vendeve përfaqësuese, duke krijuar një arenë ndërkombëtare multikulturore dhe multidisiplinore.

Dita kushtuar Arbëreshëve në kuadër të “Javës Kulturore Italiane në Shqipëri 2023”

Nga data 1 deri më 7 Qershor në shumë qytete të vendit u organizuan një sërë aktivitete për Javën Kulturore Italiane në Shqipëri 2023.

Java e Italisë udhëtoi nga veriu në jug, pasi aktivitete të shumta kulturore e artistike u planifikuan në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Përmet, Gjirokastër, Korçë, Berat, etj.. Mes tyre edhe kremtimi i ditës kushtuar Arbëreshëve, përkatësisht më 6 Qershor 2023.



Ministria e Kulturës, mori pjese në edicionin e 35-të të Panairit Ndërkombëtar të Librit në Torino titulluar “Attraverso lo Specchio”, i cili në koncept ka eksplorimin e botës që shtrihet përtej pasqyrit të shikimit, ne cilësinë si “ e ftuara e nderit”.

Më datë 21 Maj 2023- Ore 16:00, Salla Albania në Panair, u mbajt;

Aktiviteti me titull: “Lettere dalla Diaspora: lingue allo specchio / Letra nga diaspora: gjuhët në pasqyrë”.

Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me Qendrën Editoriale për Diasporën, Qendrën Kulturore Shqiptare "Margarita Xhepa" dhe Shkollën e Astit, Qendrën Kulturore Shqiptare të Torinos.

Në këtë takim, të titulluar "Letra nga Diaspora - Gjuhë në Pasqyrë", u diskutua për gjuhën amtare, dygjuhësinë, rëndësinë e mësimin të gjuhës shqipe dhe botimet për fëmijët e diasporës.

Morën pjesë shumë mësues të gjuhës shqipe në Itali, që me shumë pasion, krenari e dashuri ndihmojnë në ruajtjen e gjuhës, kulturës e traditave shqiptare tek fëmijët shqiptarë kudo ku ata jetojnë.

Në datat 24 qershor-1 korrik 2023, në Kalanë e Qendrës Historike të qytetit të Gjirokastrës, u zhvillua Festivali Folklorik Kombëtar, Edicioni XXI.

Ky Festival është ngjarja më e madhe kulturore jo vetëm në Shqipëri por në të gjitha trevat shqipfolëse, e cila ka për qëllim mbrojtjen, promovimin dhe përcjelljen e vlerave më të mira etnomuzikore, etnokoreografike, etnografike, veglave muzikore, riteve, zejeve, etj.

Grupe të ftuar nga Diaspora në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, 2023 ishin:

1. Grupi i Arbëreshëve të “San Marzano di San Giuseppe”;
2. Grupi “Bashkimi”, Zvicër;
3. Grupi Folklorik “Rapsodët e Gjenevës”, Zvicër;
4. Ansambli Artistik "LURA", Londër;
5. Grupi "Lotë Kurbeti", Greqi;
6. Grupi “Gjergj Kastrioti”, SHBA;
7. Grupi i valleve “Rozafati”, SHBA.

Gjithashtu dhanë koncerte:

1. Ansambli shqiptar i Këngëve dhe Valleve, Republika e Maqedonisë së Veriut;
2. Grupi përfaqësues i shqiptarëve në Malin e Zi;
3. Grupi përfaqësues i shqiptarëve, Kosovë;

Në natën finale, Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore të Kosovës, “Shota” dha një shfaqje të përbashkët me Ansamblin e Këngëve dhe Valleve të Shqipërisë.

NË PROCES

**Masa Nr.29**

Organizimi i plan - veprimit të institucioneve përgjegjëse për diasporën me Këshillin Koordinues të Diasporës për forcimin organizativ të komuniteteve shqiptare dhe përfshirjen në zhvillimin social - ekonomik të Shqipërisë.

**INDIKATORËT** : Miratimi i programit të përbashkët me Këshillin Koordinues të Diasporës.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria e Kulturës
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Është në proces, vijojnë diskutimet lidhur me zbatimin e kësaj mase gjatë mbledhjeve të zhvilluara nga Këshilli Koordinues i Diasporës për periudhën Korrik-Dhjetor 2021.

**Korrik-Dhjetor 2022:**

Agjencia Kombëtare e Diasporës informon se:

Në datë 18 dhjetor 2022, “Dita e Diasporës” u zhvillua Mbledhja e Këshillit Koordinues të Diasporës.

Qëllimi i zhvillimit të mbledhjes ishte forcimi i urave lidhëse ndërmjet diasporës dhe institucioneve shqiptare, duke krijuar një kuadër të plotë institucional në këtë drejtim, zhvillimin e një vizioni bashkëpunues përmes dialogut kuptimplotë dhe të strukturuar duke krijuar mundësi dhe mekanizma të qëndrueshëm për të kontribuar dhe vazhduar nxitjen e zgjidhjeve dhe programeve inovative të përshtatshme për interesat dhe aftësitë e pjesëtarëve të diasporës.

Në mbledhjen e Këshillit Koordinues të Diasporës morën pjesë autoritete të larta shtetërore SH.T.Z Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, znj. Olta Xhaça, Ministre për Evropën dhe Punët e Jashtme -Ministër përgjegjës për Diasporën, dhe Ministrat përkatës kontribues për çështjet e ekonomisë, arsimit, kulturës, në Diasporë.

Në mbledhje ishte pranishëm dhe Kryekomisioneri, i KQZ z. Ilirjan Celibashi.

Gjatë zhvillimit të mbledhjes u evidentua potenciali që diaspora shqiptare mbart në drejtim të kapitalit human, social dhe kulturor si dhe kultivimin e partneriteteve ndërmjet sektorëve dhe niveleve të ndryshme të Qeverisjes në Shqipëri, me qëllim përfshirjen e diasporës shqiptare në zhvillimet ekonomike, sociale, kulturore etj. në vendin e origjinës.

Gjithashtu, në kuadër të javës së diasporës, Këshilli Koordinues i Diasporës, zhvilloi takime me Presidentin e e Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z.Bajram Begaj, z.Erion Veliaj, Kryetarin e Bashkisë Tiranë, znj.Lindita Nikolla, Kryetaren e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe me përfaqësues politikë nga partitë kryesore në vend, ku u diskutua ndër tjera rreth punës së bërë si Këshill, si dhe rreth prioriteteve. Një nga prioritetet kryesore është mundësimi i votimit nga jashtë Shqipërisë për shtetasit shqiptarë, e drejtë kjo që garantohet me Kushtetutën e Shqipërisë dhe Kodin Zgjedhor.

Organizimi i Kuvendit të Diasporës Shqiptare në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Diasporës si ngjarja më e rëndësishme e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Organizimi periodik i aktivitetit mbarëkombëtar me qëllim shqyrtimin e politikave aktuale për mobilizimin e diasporës shqiptare, ku do të vlerësohen çështjet si ruajtja e gjuhës dhe kulturës, fenomeni i ikjes së trurit dhe investimet nga diaspora në Shqipëri.

**INDIKATORËT:** Krijimi i Grupit të Punës për përgatitjen dhe organizimin e Kuvendit të Diasporës Shqiptare në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Diasporës. Organizimi periodik i Kuvendit të Diasporës Shqiptare.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministra e Arsimit, Sportit dhe Rinise

**Janar-Mars 2021:**

- Këshilli Koordinues i Diasporës dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës, në cilësinë e sekretariatit teknik të Këshillit, kanë ngritur një grup pune të posaçëm. Në vijim të Urdhrit Nr.39, datë 09.09.2020 të Drejtorit Ekzekutiv, të Agjencisë Kombëtare të Diasporës “Për ngritjen e Grupit të Punës për mbështetjen e Këshillit Koordinues të Diasporës, me objekt organizimin e Kuvendit të III-të të Diasporës” janë realizuar takime me qëllim koordinimin mes Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Këshillit Koordinues të Diasporës për vijimësinë e punës mbi realizimin e Kuvendit të Diasporës Shqiptare.
- Këshilli Koordinues i Diasporës (KKD) ka ndërmarrë përgjegjësinë për organizimin e takimit (Kuvendit) për vitin 2021. Kuvendi i tretë i Diasporës është një aktivitet mbarëkombëtar, i cili synon shqyrtimin e politikave aktuale shtetërore për diasporën shqiptare, ku do të vlerësohen çështjet si ruajtja e gjuhës dhe kulturës dhe investimet e pritshme nga diaspora në vendlindje.
- Mbi vendim-marrjen për kohën, temën dhe organizimin e Kuvendit të Tretë të Diasporës Shqiptare janë organizuar konsultime me shoqata dhe grupe të interesuara në diasporën shqiptare, si dhe është shpërndarë dhe plotësuar një pyetësor, duke përfshirë ide të reja nga anëtarë të komuniteteve shqiptare jashtë vendit për organizimin e Kuvendit.

**Prill-Qershor 2021:**

- Për zbatimin e Masës 30 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën prill-qershor 2021.

Koordinimi me Republikën e Kosovës në fushën e marrëdhënieve me diasporën shqiptare në zbatim dhe rivlerësim të marrëveshjeve ekzistuese midis dy shteteve. Përgatitja dhe realizimi i marrëveshjeve dypalëshe në fushën e diasporës me të gjitha vendet të cilat vlerësohen të rëndësishme dhe “prodhuese” të diasporave shqiptare në botë.

**INDIKATORËT :** Krijimi i një Plani-Veprimi të përbashkët me Shtetin e Kosovës. Koordinimi i marrëveshjeve me Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2021**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme informon përmes komunikimit elektronik se Marrëveshjet e nënshkuara nga janari 2021 deri në dhjetor 2021 me: Kosovën -18 (tetëmbëdhjetë) marrëveshje, Malin e Zi -2 (dy) marrëveshje, Maqedoninë e Veriut - 3 (tre) marrëveshje. Ndërkohë janë në proces disa marrëveshje me këto vende të cilat po ndiqen nga institucionet përgjegjëse.
- Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën nr. 247 Prot., datë 02.09.2021 drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, informon për përfundimin e procesit të miratimit të tekstit mësimor për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe në Mërgatë, me titullin “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”niveli I”.
- Është miratuar Urdhri i Përbashkët Nr. nr. 3754 Prot., datë 29.07.2021, “Për përzgjedhjen e recensuesve për tekstin mësimor për diasporën "Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare" niveli I.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës, me shkresën Nr. 120, datë 09.07.2021, lënda: “Informacion mbi aktivitetin në Kosovë” qëllimi i kësaj shkrese është informimi i Ministrisë për Evropën e Punët e Jashtme mbi zbatimin e agjendës së përbashkët.
- Është miratuar Urdhri i Përbashkët Nr. 762/1 prot., datë 9.02.2021 i Ministrit të

Shtetit për Diasporën, Nr. 915/1 prot., datë 09.02.2021 e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Nr. 234 prot., datë 16.02.2021 e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës “Për miratimin e paketës së dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën, kriterëve për recensuesit e teksteve mësimore për diasporën dhe shpalljen e konkursit për tekstet mësimore për diasporën”.

- Është lançuar në nëntor 2021 Konkursi “Colours of Albanians 2022”, realizuar si fryt i bashkëpunimit të dy Ministrive të Punëve të Jashtme të Shqipërisë dhe Kosovës, dhe do të përmbyllet në pranverë 2022, me mbështetjen edhe të IOM Albania.
- Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të Republikës së Kosovës, prezantoi më datë 12 nëntor në Tiranë tekstin e përbashkët “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli I.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka pasuruar kategorinë “Tekste shkollore” në faqen e saj web (<http://qbd.gov.al/tekste-shkollor>) me materialet ndihmëse të përgatitura nga specialistet e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, të digjitalizuara dhe aksesueshme falas për të gjithë fëmijët dhe mësuesit në Diasporë:
  - “Mësojmë Shqip, Niveli A1”,
  - “Mësojmë Shqip, Niveli A2”,
  - “Mësojmë Shqip, Fletore Tematike, Niveli A1-A2”,
  - “Libri i mësuesit, Niveli A1”,
  - “Libri i mësuesit, Niveli A2”,
  - “Libri i leximeve plotësuese, Niveli A1”,
  - “Përralla dhe legjenda për diasporën, Lexime plotësuese dygjuhëshe”.

NË PROCES

### Masa Nr.32

Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në vendet pritëse. Organizimi i aktiviteteve mbi bazën e profesioneve të cilat nxisin rrjetet e profesionistëve dhe identifikimin e burimeve njerëzore.

**INDIKATORËT** : Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë dhe nxitja e organizimit të rrjeteve të profesionistëve. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Kulturës

#### Korrik-Dhjetor 2021:

- Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Lidhjen e Mësuesve Shqiptarë në Itali, si dhe Konsullatën e Shqipërisë në Milano organizoi dy seminare mbi mësimdhënien e gjuhës shqipe në diasporë në qytetin e Bolonjas në Itali, mbi bazën e një programi të përbashkët. Aktivitetet shërbyen dhe si një vend takimi mes institucioneve shtetërore të Italisë, Shqipërisë, Kosovës dhe mësuesve dhe nxënësve të komunitetit shqiptar, me qëllim evidentimin e problematikave dhe nevojave aktuale të mësuesve dhe adresimit të tyre për zgjidhje.
- Në kuadër të organizimit të rrjeteve të profesionistëve Agjencia Kombëtare e Diasporës gjatë vitit 2021 ka zhvilluar disa takime me profesionistë në diasporë, si: Mjekët, Juristët, Remitancat etj.

NË PROCES

#### || Masa Nr.33 ||

Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme të diasporës në Shqipëri dhe dhënia e titullit “Ambasador i Kombit”. Krijimi i rrjetit të Ambasadorëve të Kombit.

**INDIKATORËT:** Promovimi i personaliteteve dhe krijimi i rrjetit të Ambasadorëve.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë i 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

#### Janar-Mars 2021:

- Për zbatimin e Masës 33 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën janar-mars 2021.

#### Prill-Qershor 2021:

- Për zbatimin e Masës 33 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën prill-qershor 2021.

#### Korrik-Dhjetor 2021:

- Për zbatimin e Masës 33 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën Korrik-Shtator 2021, pasi zbatimi i masës lidhet me 6 mujorin e parë të vitit 2021.

## Masa Nr.34

Përgatitja e Certifikatës së Diasporës, e cila mund të aplikohet online dhe krahas regjistrimit të të interesuarit e pajis atë me një dokument të printueshëm (“Jam Shqiptar”) i cili mund të vendoset në ambiente të hapura për të pohuar identitetin kombëtar shqiptar. Ajo do të jepet e veçantë për fëmijët që mbarojnë projektin e Shkollës Verore.

**INDIKATORËT:** Realizimi i projektit të Shkollës Verore dhe shpërndarja e Certifikatës “Jam Shqiptar”.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë i 2021

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Janar-Mars 2021:**

- Për zbatimin e Masës 34 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën janar-mars 2021.

**Prill-Qershor 2021:**

- Për zbatimin e Masës 34 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën prill-qershor 2021.

## Masa Nr.35

Krijimi i Regjistrimit të Diasporës së Kualifikuar dhe zbatimi i programeve kombëtare dhe të përbashkëta me institucione ndërkombëtare me qëllim që të tërhiqen anëtarët e kualifikuar të diasporës për t’i shërbyer ekonomisë së Shqipërisë. Vlerësimi i programeve që nxisin investitorët që të punësojnë staf të kualifikuar nga diaspora jashtë vendit. Mbi bazën e këtyre programeve, koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë që të mirëprehen dhe të ndihmohen nga anëtarë të diasporës shqiptare për të lehtësuar studimet e tyre në universitete të huaja nëpërmjet një rrjeti të ngritur për këtë qëllim në diasporë.

**INDIKATORËT :** Realizimi i Regjistrimit të Diasporës së Kualifikuar; Programet kombëtare; Vlerësimi i programeve; Koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë. Organizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2023 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

**Janar-Qershor 2023:**

Agjencia Kombëtare e Diasporës gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, ka vijuar punën për pasurimin a databazës, me të dhëna nga pjesëtarë të kualifikuar të diasporës shqiptare.

Gjithashtu vëmendje e veçantë i është kushtuar brezit të ri në diasporë me fokus primar studentët shqiptarë në diasporë.

Krijimi i Bazës së të Dhënave Shtetërore të Studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe Shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë” ka si institucion administrues Agjencinë Kombëtare të Diasporës, dhe përbën zhvillimin e një sistemi informatik për automatizimin e procedurës së përfitimit të bursave të studimit nga Republika e Shqipërisë , i cili në zbatim të politikave të institucionit do të përmirësojë procesin e regjistrimit , verifikimit dhe menaxhimit të të gjithë të dhënave të nevojshme të studentëve , të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare , të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë”.

Informacion i detajuar mund të konsultohet në linkun: <https://akd.gov.al/studentet/>

NË PROCES

**Masa Nr.36**

Evidentimi i shoqatave kulturore, sportive, arsimore, sociale, shkencore që veprojnë në vendet pritëse si dhe i individëve të talentuar dhe të suksesshëm që veprojnë në diasporë. Krijimi i një regjistri të veçantë për këtë qëllim.

**INDIKATORËT :** Evidentimi i shoqatave dhe krijimi i një regjistri. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Kulturës



## Korrik-Dhjetor 2021:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike ka përditësuar listën e të gjitha shoqatave dhe organizatave shqiptare në diasporë për vitin 2021.
- Agjencia Kombetare e Diasporës, informon se ka krijuar një përmbledhje të dhënash mbi shoqatat dhe organizatat shqiptare në diasporë dhe i ka publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë.

## Janar-Qershor 2022:

Dhoma e Biznesit të Diasporës ka realizuar gjatë vitit 2022 aktivitetin e përmuajshëm Mirëmëngjes Diasporë.

Një aktivitet i cili synon që të kthehet në një traditë, bashkon dhjetra sipërmarrës shqiptarë, nga Diaspora, organizata dhe palë të interesuara për të diskutuar mbi rëndësinë dhe potencialet e investimit në Shqipëri, sfidat dhe problematikat me të cilat ndeshen bizneset në vendin Tonë. “Mirëmëngjes Diasporë” është një aktivitet i cili organizohet çdo muaj me qëllimi rrjetëzimin, komunikimin dhe mbështetjen e sipërmarrësve shqiptar.

### Tryeza e partnereve

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare ka organizuar në muajin mars një takim me partnerë, donatorë dhe palë të interesit ku prezantoi “Perspektivat e reja të investimit në atdhe”.

Në këtë takim prezantuan dy projektet ambicioze: “Fluturo me shqipen” dhe “Instrumenti financiar i Diasporës”

Qëllimi kryesor i projektit “Fluturo me shqipen” është të theksojë rëndësinë e produkteve “Made in Albania”, promovimin e tyre si dhe të krijojë mbështetje për krijimin e një zinxhiri vlerash nga prodhimi në depërtimi i tregut, drejt konsumatorit shqiptar në diasporë. Pasi sipërmarrja e Diasporës zotëron kapacitetin e duhur për të rritur prodhimet vendase nëpërmjet fuqizimit të Markës Shqiptare. Në të njëjtën kohë, kjo nismë do të ketë një ndikim pozitiv në punësimi dhe rritjen e të ardhurave, duke kontribuar për një të qëndrueshme ekonomisë.

Ndërsa projekti i dytë “Instrumenti financiar i Diasporës” synon krijimin e Logjistikës Financiare për Zhvillimin e Investimeve të Diasporës Shqiptare në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Kosovë. Një instrument i cili do të ndikojë në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet sipërmarrjeve shqiptare në mbarë botën.

NË PROCES

**Masa Nr. 37**

Nxitja e organizimeve të Rrjetit të Grave në Diasporë dhe ndërtimi i politikave të veçanta në këtë drejtim. Organizimi në Shqipëri ose jashtë saj i Samitit të Grave të Diasporës. Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm me organizatat dhe me institucionet që mbulojnë këtë çështje në vendet pritëse dhe me shoqërinë civile në Shqipëri për këtë qëllim.

**INDIKATORËT** : Organizime të Rrjetit të Grave në Diasporë; Organizimi i Samitit të Grave të Diasporës.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

#### Korrik-Dhjetor 2022:

Në datë 21 Shtator 2022, në Tiranë, u zhvillua Samiti i Tretë i Grave të Biznesit në Diasporë, organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare. Tema qendrore e Samitit ishte “Gruaja për Zhvillim të Qëndrueshëm”. Në event u mbledhën rreth 100 gra sipërmarrëse dhe drejtuese të organizatave të ndryshme nga Shqipëria dhe Kosova. Në të morën pjesë personalitete nga vendi, rajoni dhe gra nga diaspora. Gra përfaqësuese nga organizata shqiptare nëpër botë, theksuan nevojën e bashkëpunimit, duke u shprehur të gatshme të mbështesin të rejtat shqiptare përmes ndarjes së njohurive të fituara jashtë vendit.

Nga ky Samit lindi nevoja e ndërtimit të një rrjeti ekselence për gratë duke forcuar marrëdhëniet mes grave në biznes, të cilat ndodhen në diasporë. Në event u ngritën të gjitha shqetësimet dhe problematikat e tyre si edhe u ofrua një sërë rastesh suksesi për t’i motivuar gratë në biznes. Ky ishte një moment që i dha zë gruas shqiptare. Mbi të gjitha ky event krijoi një network, i cili do të mbajë gjatë dhe fort lidhjet me gratë bashkërisht për të forcuar njëra tjetrën.

#### Janar-Qershor 2023:

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare ka lançuar zhvillimin e Samitit të Gruas të Diasporës Shqiptare IV, i cili do të mbahet në Tiranë, në datë 14 Shtator 2023.

NË PROCES

### **Masa Nr. 38**

Forcimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës në bashkëpunim me rrjetin e bizneseve në diasporë. Krijimi i Regjistrimit të Bizneseve të Diasporës si bazë e organizimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës si protagoniste në marrëdhëniet e biznesit me administratën shtetërore.

**INDIKATORËT** : Aktivitet vjetor me Dhomën e Biznesit të Diasporës; Krijimi i Regjistrimit të Bizneseve të Diasporës.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022

## INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

### Janar-Qershor 2022:

Është miratuar Ligji Nr.25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-eve” Nëpërmjet këtij ligji ofrohet mundësia e pjesëtarëve të diasporës për të ngritur startup-et e tyre dhe për të investuar në Shqipëri. Është mundësuar shërbimi “Pasaporta e Start-up” përmes aplikimit (vetëdeklarimit) on-line.

Më datë 20 maj 2022 është zhvilluar Takim në Rajonin e Lombardisë me pjesëmarrje të Presidentit të Rajonit të Lombardisë Z. Atilio Fonttana dhe nënsekretarin e deleguar për Marrëdhëniet me Delegacionet Ndërkombëtare Z. Alan Christian Rizzi për thellimin e bashkëpunimit ekonomik me të dy vendet.

Në vijim të takimit u diskutua mbi institucionalizimin dhe ngritjen e urave të bashkëpunimit me diasporën shqiptare, në bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës dhe Dhomën e Tregtisë Italiane në Shqipëri. Një rëndësi të veçantë i kushtohet nxitjes së të rinjve nga diaspora për të kontribuar në zhvillimin e atdheut të tyre si nëpërmjet pjesëmarrjes në tregun e punës, duke filluar një biznes, dërguar remitanca, krijuar lidhje biznesi me kompanitë në Shqipëri ashtu edhe duke ofruar konsultime falas kolegëve dhe kompanive në vendlindje.

Bashkëpunim me Organizatën “GERMIN” në Shqipëri, për projektin më të ri “OriginAL”, i cili është një mekanizëm, që i shërben forcimit të lidhjeve të diasporës me Shqipërinë, duke inkurajuar angazhimin dhe përfshirjen e saj në jetën social ekonomike të vendit të origjinës.

Takim me Këshillin Kordinues të Diasporës për çështje të ndryshme, ku ndër më prioritarët është regjistrimi i të gjithë popullsisë shqiptare në botë, në regjistrin kombëtar të gjendjes civile shqiptare, si një mënyrë efikase për realizimin e votimit në diasporë, e drejtë e të gjithë shqiptarëve që jetojnë e punojnë jashtë.

NË PROCES

### **Masa Nr.39**

Krijimi i strukturave administrative në pushtetin lokal për informimin dhe mbështetjen investimeve nga të interesuarit në diasporë. Ky informim i diasporës do të jetë i koordinuar për mundësitë e investimeve në Shqipëri për motivimin e bizneseve apo migrantëve shqiptarë për të investuar në sektorë të veçantë të ekonomisë.

**INDIKATORËT :** Krijimi i strukturave administrative në nivel lokal; Program për informimin e diasporës për investimet. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2022 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- **Ministria e Brendshme**
- **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**
- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes**

**Korrik-Dhjetor 2022:**

Ngritja e strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë së vetëqeverisjes vendore, mbështetet në ndryshimet ligjore në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore ». Bashki që kanë hartuar planin vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën Në sajë të mbështetjes së Qeverisë Gjermane dhe Programit Migracioni dhe Diaspora, i zbatuar nga GIZ, Bashkitë të cilat kanë hartuar Planet e Veprimit për Migracionin dhe Diasporën janë si vijon:

- Tiranë
- Korçë,
- Elbasan
- Shkodër
- Kukës
- Dibër

Ndër Bashkitë sipërcituar kanë miratuar planin vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën :

- Tiranë
- Korçë,
- Kukës
- Dibër

NË PROCES

**Masa Nr.40**

Vlerësim vjetor për remitancat dhe politikat nxitëse bankare për diasporën shqiptare nën drejtimin e Bankës së Shqipërisë. Përpunimi dhe zbatimi i një politike koherente dhe të plotë për administrimin e dërgesave të diasporës. Rivlerësim për marrjen e masave për të rritur flukset e dërgesave të migrantëve duke motivuar migrantët që sjellin kursimet e tyre në Shqipëri.

**INDIKATORËT** : Aktivitet për vlerësim vjetor për remitancat; Vlerësim i politikave koherente për flukset e dërgesave nga jashtë vendit.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2022**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**

- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

### Janar-Qershor 2022:

Dhoma e Biznesit të Diasporës, anëtare e Këshillit të Investimeve që prej vitit 2019, merr pjesë rregullisht në mbledhjet dhe takimet e këtij Këshilli. Në muajin shkurt 2022 u përfaqësua nga Kryetari i saj, Z. Ardian Lekaj në mbledhjen e jashtëzakonshme për të prezantuar shtyllat prioritare të ndërhyrjes së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për përmirësimin e klimës së investimeve, në vijim të rekomandimeve të KI dhe komunitetit të biznesit.

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare ka krijuar projektin “Instrumenti financiar i Diasporës” i cili synon krijimin e Logjistikës Financiare për Zhvillimin e Investimeve të Diasporës Shqiptare në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë- një instrument i cili do të ndikojë në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet sipërmarrjeve shqiptare në mbarë botën.

NË PROCES

### **Masa Nr.41**

Vlerësimi vjetor i masave për kalimin e dërgesave të migrantëve nga rrugët informale të transferimit në ato formale, dhe më pak të kushtueshme. Vendosja e një dialogu periodik me përfaqësuesit e sistemit bankar të vendit për këtë çështje. Nxitja e shoqërive private për të tërhequr dërgesat e emigrantëve nëpërmjet produkteve financiare (si p.sh.: letra me vlerë).

**INDIKATORËT** : Realizimi i aktivitetit vjetor për formalizimin e dërgesave nga diaspora në dialog me përfaqësuesit e sistemit bankar.

**AFATI KOHOR:** 6 muaji i parë 2022

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

### Janar-Qershor 2022:

- Për zbatimin e Masës 41 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën Janar-qershor 2022.

NË PROCES

### **Masa Nr.42**

Krijimi i zyrave të posaçme administrative në institucionet përgjegjëse të ekonomisë për trajtimin e diasporës shqiptare sidomos në zbatimin e politikave të dërgesave të migrantëve dhe lehtësimin e tërheqjes së investimeve nga diaspora.

**INDIKATORËT** : Krijimi i zyrave administrative në institucionet përgjegjëse financiare.

**AFATI KOHOR**: 6 muhori i parë 2022

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS**:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

**Janar-Qershor 2022:**

- Për zbatimin e Masës 42 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën janar-qershor 2022.

NË PROCES

**Masa Nr.43**

Bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe sistemin bankar privat për nxitjen e zgjerimit të shërbimeve bankare në vendet pritëse të diasporës si dhe për të afërmit e tyre në Shqipëri (kryesisht në zonat rurale). Nxitja e bankave në vendet pritëse që me ndihmën e shoqatave të migrantëve shqiptarë, të përcaktojnë shërbime “ad hoc” për emigrantët (brenda shkallës së mundësisë dhe negocimit).

**INDIKATORËT** : Aktivitet vjetor për rivlerësimin për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve bankare.

**AFATI KOHOR**: 6 muhori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS**:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Banka e Shqipërisë ka publikuar botimin vjetor “Pandemia dhe Remitancat”. Në këtë botim theksohet se remitancat, në kontekstin e zhvillimeve aktuale ekonomike, mbeten një potencial i madh për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik shqiptar, prandaj ato duhet të karakterizohen dhe trajtohen si resurse dhe si një kategori thelbësore në ekonomi.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës, ka zhvilluar takimin “Dita Ndërkombëtare e Remitancave” për rolin që luajnë remitancat në vendit tonë por dhe sugjerime në drejtim të formalizimit të dërgesave, përmes përmirësimit dhe zgjerimit të shërbimeve bankare. Në këtë takim morën pjesë krahas përfaqësuesve shtetërorë dhe përfaqësues nga sistemi bankar.

Organizimi periodik i takimeve me rrjetet e biznesit në diasporë dhe i shkëmbimit të informacionit funksional nga çdo institucion që mbulon fushën e interesit për të investuar në vendlindje.

**INDIKATORËT :** Takime vjetore me rrjetet e biznesit dhe i shkëmbimit të informacionit.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka informuar përmes komunikimit elektronik, se vijohet me planin e promovimit të produkteve shqiptare, në bashkëpunim me GIZ.
  - Është bërë promovimi i produkteve bujqësore shqiptare si: bimët medicinale, fruta-perime, produkte tradicionale shqiptare, produktet blegtorale(online);
  - Janë organizuar aktivitete me fokus "Promovimin e Verës Shqiptare" dhe "Mbështetja e Grave Rurale" (në periudhën shtator - tetor 2021) ;
  - Panairi kombëtar dedikuar bujqësisë "Shqipëria Punon Tokën", parashikuar të mbahej në muajin Tetor 2021, është anuluar (duke evituar grumbullimet e mëdha, për shkak të vijimit të pandemisë Covid 19, për të njëjtën arsye janë anuluar dhe takimet me rrjetin e bizneseve të diasporës.

**Janar-Qershor 2022:**

Dhoma e Biznesit te Diasporës ka realizuar gjatë vitit 2022 aktivitetin e përmuajshëm Mirëmëngjes Diasporë.

Një aktivitet i cili synon që të kthehet në një traditë, bashkon dhjetra sipërmarrës shqiptarë, nga Diaspora, organizata dhe palë të interesuara për të diskutuar mbi rëndësinë dhe potencialet e investimit në Shqipëri, sfidat dhe problematikat me të cilat ndeshen bizneset në vendin Tonë. "Mirëmëngjes Diasporë" është një aktivitet i cili organizohet çdo muaj me qëllimi rrjetëzimin, komunikimin dhe mbështetjen e sipërmarrësve shqiptar.

- Forumi i Bizneseve

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare mori pjesë në konventën e Rrjeteve të Bizneseve të Diasporës Shqiptare në Evropë. Kjo konventë ofroi mundësi për krijimin e lidhjeve dhe partneriteteve mes bizneseve të Diasporës dhe Kosovës, me qëllim të rritjes së eksportit dhe zhvillimit e prodhimit në . Gjatë kësaj konvente dy-ditore, bizneset do të kenë mundësi të marrin pjesë në takime B2B, në prezantime tematike etj.

NË PROCES

#### **Masa Nr.45**

Vlerësimi dhe nxitja e migrimit qarkullues ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë me anë të masave favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale (duke i dhënë përparësi Greqisë dhe Italisë). Realizimi një zyre kontakti dhe koordinimi për vlerësimin dhe monitorimin e gjendjes së tregjeve të huaja të punës dhe me pas ky informacion t'i kalohet institucioneve përgjegjëse.

**INDIKATORËT :** Realizimi i një programi të veçantë për masat favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale; Ngritja e një zyre kontakti dhe koordinimi për tregjet e huaja të punës. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Bujqësisë

**Korrik-Dhjetor 2022:**

- Për zbatimin e Masës 45 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën korrik-dhjetor 2022.

NË PROCES

#### **Masa Nr.46**

Organizimi i një programi të veçantë aktivitetesh vjetore për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare duke organizuar aktivitete periodike në funksion të rrjeteve të organizuara të prodhuesve shqiptarë dhe rrjetit të bizneseve shqiptare në diasporë të cilët tregtojnë prodhime të natyrave të tilla.

**INDIKATORËT :** Program vjetor me aktivitete për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare.



**AFATI KOHOR: 6 maji i parë 2022 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

**Janar-Qershor 2022:**

Në Berlin është zhvilluar panairi më i madh i marketimit të produkteve bujqësore në Europë ku marrin pjesë 135 shtete, ku edhe Shqipëria është përfaqësuar me 11 (njembëdhjetë) nga kompanitë më të mëdha të prodhimit dhe përpunimit bujqësor. Në panair, kanë aksesuar vizitorë të huaj dhe nga diaspora shqiptare. Kompanitë shqiptare kanë patur mundësinë të zhvillojnë takime biznesi B2B me kompani të tjera.

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare ka lancuar projektin “Fluturo me shqipen”, një projekt i cili do të theksojë rëndësinë e produkteve “Made in Albania”, promovimin e tyre si dhe të krijojë mbështetje për krijimin e një zinxhiri vlerash nga prodhimi në depërtimin në treg, drejt konsumatorit shqiptar në diasporë. Sipërmarrjet e Diasporës zotërojnë kapacitetin e duhur për të rritur prodhimet vendase nëpërmjet fuqizimit të Markës Shqiptare. Në të njëjtën kohë, kjo nismë do të ketë një ndikim pozitiv në punësimin dhe rritjen e të ardhurave, duke kontribuar për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë.

**| Masa Nr.47 |**

**NË PROCES**

Zhvillimi i aktiviteteve vjetore në fushën e prodhimeve vendase në koordinim me bizneset blerëse në diasporë në funksion të krijimit të hartëzimit së restoranteve dhe bizneseve të ushqimit në shtetet pritëse për të ndërlidhur me një projekt të veçantë bizneset shitëse dhe blerëse brenda dhe jashtë vendit.

**INDIKATORËT:** Zhvillimi i aktiviteteve vjetore; Krijimi i hartës së restoranteve dhe bizneseve.

**AFATI KOHOR: 6 maji i parë 2022 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

**Janar-Qershor 2022:**

Agjencia Kombëtare e Diasporës informon se ka krijuar dhe përditëson bazën e të dhënave në funksion të krijimit, ndër to dhe në kuadër të hartëzimit të bizneseve të ushqimit dhe restoranteve që operojnë në diasporë.

**Masa Nr.48**

Krijimin e një programi të veçantë ndihme për institucionet e mikrokreditimit për zbatimin e politikave që synojnë kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet financiare në vendet pritëse. Inkurajimi i shoqatave të migrantëve për nxitjen e zhvillimit lokal nëpërmjet mbledhjes vullnetare të donacioneve nga anëtarët për të financuar projekte të ndryshme në qytetin apo fshatin e tyre.

**INDIKATORËT** : Realizimi i një aktiviteti vjetor në ndihmë për institucionet e mikrokreditimit.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

**Janar-Qershor 2022:**

- Për zbatimin e Masës 48 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën korrik-dhjetor 2022.

**Masa Nr.49**

Rivlerësimi i politikave me qëllim nxitjen e kthimit të migrantëve të kualifikuar. Vlerësimi i ofertës dhe kërkesës për personel të kualifikuar, në tregun e punës shqiptar dhe krijimi i kontakteve ndërmjet migrantëve dhe ndërmarrjeve të mesme e të mëdha në Shqipëri, duke krijuar një bankë të dhënash elektronike me CV e migrantëve të kualifikuar.

**INDIKATORËT** : Krijimi i një banke të dhënash elektronike të profesionistëve në diasporë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

## **Korrik-Dhjetor 2021:**

- Në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim”, funksionon platforma “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”, e cila është krijuar me qëllim hartëzimin e profesionistëve shqiptarë në Diasporë. Ajo u vjen në ndihmë anëtarëve të Diasporës duke iu ofruar mundësinë për të kapërcyer barrierat gjeografike, për të lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin ndërmjet tyre. Platforma Rrjeti i Profesionistëve i ofron përdoruesve profesionistë shqiptarë në Diasporë mundësi informimi, mundësi bashkëpunimi, mundësi punësimi, investimi etj.

NË PROCES

### **|Masa Nr.50|**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të jetë koordinuese për realizimin në bashkëpunim me sektorin e biznesit privat një program për shpërndarjen e informacioneve të karakterit ekonomik dhe përpilimin e një programi aktiviteteve vjetore periodike, që nxit marrëdhëniet e biznesit ndërmjet komuniteteve shqiptare në diasporë, me njëri-tjetrin dhe vendlindjen.

**INDIKATORËT :** Realizimi i strukturës së informimit nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për biznesin privat; Përpilimi i një programi aktiviteteve vjetore periodike.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

## **Korrik-Dhjetor 2021:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike dërgon rregullisht informacione me karakter ekonomik dhe materiale promovuese mbi turizmin, kulturën, mundësitë për investime etj, të cilat pasqyrohen në aktivitete dhe takime të ndryshme që organozojnë përfaqësitë. Kjo shërben për rritjen e imazhit të Shqipërisë kudo në botë.

## **Janar-Qershor 2022:**

Çdo muaj Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare ka publikon buletin e saj informativ. Një përmbledhje e informacioneve dhe aktivitete që ka realizuar si dhe informacione të tjera utilitare për të gjithë sipërmarrësit shqiptar kudo që ndodhen dhe lexuesit e interesuar.

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare ka përgatitur pr vitin 2022 një kalendar aktiviteteve ku përfshihen evenimente të ndryshme, trajnime, takime B2B etj. Kalendarin mund ta gjeni të plotë këtu:

<https://adbc.al/trajnimet-2022/>

**Masa Nr.51**

Realizimi i programit të festave dhe ditëve të shënuara komunitare në bashkëpunim me sektorin privat, organizatat jofitimprurëse apo ato sportive dhe promovimi nga institucionet përgjegjëse të turizmit në tregje të rëndësishme për të rritur flukset turistike.

**INDIKATORËT :** Realizimi i një Programi vjetor aktiviteteve në funksion të sezonit turistik në Shqipëri.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Kulturës

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka përcjellë me mjete të komunikimit elektronik kalendarin e festave lokale të planifikuara për vitin 2021 dhe informon se ka për qëllim promovimin e turizmit, traditave, vlerave kulturore dhe historike si dhe produkteve vendase.

**Masa Nr.52**

Rishikimi i praktikave dhe kushteve për arsimimin e brezave të rinj të diasporës në gjuhën shqipe. Rivlerësimi i hartimit të kurrikulave standarde për mësimdhënien në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë.

**INDIKATORËT :** Realizimi i një aktiviteti vjetor për rishikimin e praktikave dhe kushteve për arsimimin dhe rivlerësimin i hartimit të kurrikulave për mësimdhënien.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Akademia e Shkencave

## Korrik-Dhjetor 2022:

Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD) në kuadër të 110-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë dhe të 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, organizoi aktivitetin dyditor me titull “Shqipja në diasporë”.

Ky aktivitet u organizua në koordinim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Albanologjike dhe me praninë e institucioneve kryesore kërkimore shkencore dhe universitare në Shqipëri, Kosovë e diasporë, të institucioneve të mësimdhënies së gjuhës shqipe në botë, si dhe të autorëve, shkrimtarëve e përkthyesve brenda dhe jashtë vendit.

Aktiviteti u zhvillua në datat 26 nëntor 2022 në Tiranë dhe 27 nëntor 2022 në Shkodër, me prani fizike dhe virtuale.

“Shqipja në diasporë” ishte një aktivitet që synoi ndërtimin e një dialogu ndërinstytucional dhe ndërshtetëror me qëllim nxitjen e hartimit të politikave bashkëkohore dhe programeve mbarëkombëtare për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare jashtë vendit; fuqizimin e bashkëpunimit me institucionet e mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë; shkëmbimin e përvojave midis mësuesve, gjuhëtarëve, autorëve, shkrimtarëve dhe përkthyesve për problemet që lidhen me mësimin, përdorimin, ruajtjen dhe promovimin e gjuhës shqipe në mërgatë. “Shqipja në diasporë” ishte një dritare dialoguese e gjuhëtarëve, studiuesve, mësuesve të gjuhës shqipe, institucioneve për të theksuar që tashmë ka ardhur koha për një program të mirëmenadur dhe ndërqeveritar për gjuhën shqipe në Diasporë. U diskutua se Shtete shqipfolëse në Ballkan, kanë mundësinë e madhe që të bëhen bashkë të gjithë për të ndërtuar një program të mirëmenadur midis dy vendeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e gjuhës shqipe në Diasporë”.

Akademia e Shkencave përmes komunikimit elektronik na informon lidhur me vendimin e Kryesisë së Akademisë së Shkencave nr. 69, datë 13.12.2021 "Për krijimin e njësisë kërkimore-studimore për arbëreshët, arvanitët dhe arbneshët (më tej: NJKS-AAA), ku është ngritur njësi kërkimore studimore e cila ka për qëllim përqendrimin e dijes dhe rritjen e cilësisë e të profesionalizmit në këtë fushë veprimi të albanologjisë si dhe forcimin e perspektivës së tyre, ndërmjet ndërmarrjes dhe realizimit të projektve dhe studimeve të veçanta.

Pjesë e rëndësishme e këtij vendimi janë ndjekja e katër projekteve madhore, ku:

- Botimi i Vëllimi I deri Vëllimi III “Opera omnia” të Fr. A. Santorit është planifikuar për vitin e ardhshëm.
- Përfundimi i fjalorit të arbërishtes së shkruar dhe të folur.
- Përfshirja e fjalorit arbëresh në Fjalorin e Madh të Gjuhës Shqipe.
- Është parashikuar botimi për “Barleti i rizbuluar”, i cili është shtyrë për një moment të dytë.

NË PROCES

### **| Masa Nr.53 |**

Vlerësimi vjetor i nevojave për libra për mësimin në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë. Përmirësim periodik i kurrikulave të përbashkëta me Kosovën, për mësimdhënien në gjuhën shqipe. Mbështetje në zbatimin e kurrikulave të përbashkëta.

**INDIKATORËT :** Realizimi i një aktiviteti për vlerësimin vjetor të nevojave dhe cilësisë së librave të kurrikulës së përbashkët me Republikën e Kosovës.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Është miratuar urdhër i përbashkët Nr. 3754, datë 29.07.2021 “Për përzgjedhjen e recensueseve për tekstin mësimor për diasporën “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” Niveli I. Komisioni i përbashkët Shqipëri-Kosovë ka rol të rëndësishëm për miratimin e teksteve mësimore të diasporës.
- Komisioni i përbashkët Shqipëri-Kosovë u mbledh në Prishtinë më datë 12-13 korrik 2021 për “Miratimin e kalendarit të punës për përzgjedhjen e recesentëve. Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën Nr. 217, datë 23.07.2021, drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministrit të Shtetit për Diasporën dërgon informacion mbi punën e Komisioni të përbashkët Shqipëri-Kosovë për kualifikimin e recesentëve për vlerësimin e Teksteve Mësimor për Diasporën.
- Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën Nr. 158, datë 11.06.2021, drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministrit të Shtetit për Diasporën dërgon informacion mbi takimin e datës 9 qershor të Komisioni i përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e teksteve mësimore të diasporës.
- Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën Nr. 190/1, datë 07.07.2021, drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministrit të Shtetit për Diasporën për prodhimin e certifikatave të nxënësve në diasporë sipas kërkesës së përcjell nga MASR-ja, ku informon se janë prodhur 33 (tridhjetë e tre) certifikata për nxënësit sipas listës së përcjell nga MASR.
- Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të Republikës së Kosovës, prezantoi më datë 12 nëntor në Tiranë tekstin e përbashkët “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli I.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka përcjell shkresën Nr. 13464 Prot., datë 30.09.2021, lënda: “Kërkesë për libra nga Biblioteka Ndërkombëtare e Stockhilit”, ku janë përcjellë kërkesa për sigurimin e një sasive librash shqip për grupmosha të ndryshme nga Biblioteka Ndërkombëtare e Stockhilit. Qendra e Botimeve për Diasporën ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 261/1 Prot., datë 11.10.2021 Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka përcjellë shkresën nr. 285/2 Prot., datë 25.11.2021 Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, lënda: “Informacion mbi

dërgesën e teksteve plotësuese në Greqi”.

- Qendra e Botimeve për Diasporën ka përcjellë shkresën nr. 287 Prot., datë 25.11.2021 Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, lënda: “Kthim përgjigje shkresës nr.16795 Prot., datë 22.11.2021, “Për kërkesën për literaturë plotësuese për shkollat në Diasporë”.
- Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën Nr. 217, datë 23.07.2021, drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministrit të Shtetit për Diasporën informon mbi punën e Komisioni të përbashkët Shqipëri-Kosovë për kualifikimin e recesentëve për vlerësimin e Teksteve Mësimor për Diasporën”. Komisioni i përbashkët Shqipëri-Kosovë u mbledh në Prishtinë më datë 12-13 korrik 2021 për “Miratimin e kalendarit të punës për përzgjedhjen e recesentëve.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka finalizuar projektin për përgatitjen e materialeve në ndihmesë të mësimdhënies në Diasporë, për nivelin e parë mësimor, në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar me Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, të Universitetit të Tiranës me nr. 269 Prot. datë 01.10.2020 me synim bashkëpunimin e ndërsjellë institucional. Qendra e Botimeve për Diasporën finalizoi këtë projekt në muajin korrik.
- Qendra e Botimeve për Diasporën, përmes VKM-së nr. 756, datë 23.09.2020, “Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për diasporën”, ka mbështetur punën e Komisionit duke realizuar funksionin e sekretariatit teknik të këtij komisioni.  
Gjatë vitit 2022, Qendra e Botimeve për Diasporën ka koordinuar dy mbledhje të Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe të Kosovës:  
Më datë 29 shtator u organizua në mjediset e QBD-së në Tiranë tryeza e përbashkët e punës me përfaqësues nga institucionet qendrore përgjegjëse për diasporën të Kosovës dhe të Shqipërisë. Ky takim u organizua me kërkesë të QDB-së, në kuadër të vijimit të punës për zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta.  
Tema të punës së kësaj tryeze të përbashkët ishin:
  - Koordinimi i punës për grupet e përbashkëta të punës për plotësimin e kërkesave dhe shpërndarjen e teksteve në diasporë;
  - Përcaktimi i hapave për vijimin e punës së Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për tekstet e përbashkëta për mësimdhënien në diasporë;
  - Koordinimi i punës për organizimin e seminareve, trajnimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta për mësimdhënien në diasporë.

Më datë 12 - 13 dhjetor 2022, Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën rinisi punën, duke zhvilluar mbledhjen e radhës në Prishtinë me qëllim planifikimin e punës për shpalljen e konkursit për hartimin dhe miratimin e teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe III.

Në përfundim të këtij takimi, komisioni miratoi: Vendimin nr. 1 për kalendarin e punës për vitin 2023 dhe Vendimin nr. 2 për rishikimin e paketës së dokumenteve për procedurat e konkursit të teksteve mësimore për diasporën

Koordinimi dhe nxitja e marrëveshjeve të përbashkëta me shtetin e Kosovës për mbështetjen e mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë. Rivlerësim për kuadrin ligjor lidhur me përgjegjësinë e shtetit shqiptar për të mundësuar mësimin e gjuhës shqipe për brezin e ri të komuniteteve shqiptare në diasporë.

**INDIKATORËT** : Krijimi i një Komisioni Teknik për vlerësimin e Marrëveshjeve me Republikën e Kosovës për takime e konkluzione vjetore.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

**Janar-Qershor 2022:**

- Më herët në kohë është lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, datë 23.03.2015, *“Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”*.

**Korrik-Dhjetor 2022:**

- Qendra e Botimeve për Diasporën, përmes VKM-së nr. 756, datë 23.09.2020, *“Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për diasporën”*, ka mbështetur punën e Komisionit duke realizuar funksionin e sekretariatit teknik të këtij komisioni.  
Gjatë vitit 2022, Qendra e Botimeve për Diasporën ka koordinuar dy mbledhje të Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe të Kosovës:  
Më datë 29 shtator u organizua në mjediset e QBD-së në Tiranë tryeza e përbashkët e punës me përfaqësues nga institucionet qendrore përgjegjëse për diasporën të Kosovës dhe të Shqipërisë. Ky takim u organizua me kërkesë të QDB-së, në kuadër të vijimit të punës për zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta.  
Tema të punës së kësaj tryeze të përbashkët ishin:
  - Koordinimi i punës për grupet e përbashkëta të punës për plotësimin e kërkesave dhe shpërndarjen e teksteve në diasporë;
  - Përcaktimi i hapave për vijimin e punës së Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për tekstet e përbashkëta për mësimdhënien në diasporë;
  - Koordinimi i punës për organizimin e seminareve, trajnimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta për mësimdhënien në diasporë.



Më datë 12 - 13 dhjetor 2022, Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën rinisi punën, duke zhvilluar mbledhjen e radhës në Prishtinë me qëllim planifikimin e punës për shpalljen e konkursit për hartimin dhe miratimin e teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe III. Në përfundim të këtij takimi, komisioni miratoi: Vendimin nr. 1 për kalendarin e punës për vitin 2023 dhe Vendimin nr. 2 për rishikimin e paketës së dokumenteve për procedurat e konkursit të teksteve mësimore për diasporën.

### Janar-Qershor 2023:

Vijimi i bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës në fushën e arsimit

- Zhvillimi i seminarit të “Gjuhës Shqipe dhe Kulturës Shqiptare në Diasporë”.

150 (Njëqind e pesëdhjetë) mësues jo vetëm nga Evropa, por nga vende të ndryshme të botës, Britania e Madhe, Turqia, Greqia etj, u mbledhën në Vlorë në seminarin treditör për mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë ku merrnin pjesë Ministrija e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë znj.Evis Kushi, Ministrija e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës znj.Arbërie Nagavci, Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha, Kryetari i Nënkomisionit Parlamentar për Diasporën dhe Migracionin z.Lavdrim Krashi, etj.

Gjatë seminarit u vlerësua rëndësia e ruajtjes së gjuhës shqipe, kulturës, traditave dhe identitetit kombëtar shqiptar për brezat e rinj shqiptarë që po rriten përtej kufijve.

NË PROCES

### **Masa Nr.55**

Përditësimi i Regjistrit të mësuesve në diasporë dhe i programeve për mbështetje në zbatimin e standardeve për mësuesit në diasporë. Certifikimi i mësuesve dhe hartim i skemës së pensioneve për mësuesit në diasporë. Organizimi i aktiviteteve arsimore vjetore me mësues e nxënës shqiptarë në diasporë.

**INDIKATORËT** : Realizimi i Regjistrit të mësuesve, krijimi i programeve mbështetëse; Organizimi vjetor i aktiviteteve me mësuesit në diasporë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

### Janar-Qershor 2022

Nuk ka informacion të përditësuar.

## Korrik-Dhjetor 2022:

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) me shkresën NR. 1091/1 Prot., datë 21.11.2022 i ka përcjellë Qendrës së Botimeve për Diasporën listën e plotë emërore që janë bërë pjesë e regjistrit shtetëror të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare për vitin 2019-2022. Për vitin 2022 lista është plotësuar me 7 (shtatë) emra të rinj mësuesish.

NË PROCES

### | Masa Nr.56 |

Krijimi i një strukture permanente e cila do të ndjekë trajnimin e mësuesve që do të japin mësim në diasporë. Sigurimi i vazhdueshëm i teksteve shkollore për diasporë dhe trajnimi i mësimdhënësve mbi kurrikulat e përbashkëta me Kosovën. Dërgimi i mësuesve me kontratë nga Shqipëria në shtetet pritëse nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

**INDIKATORËT :** Forcimi i strukturës permanente (Qendrës së Botimeve në Diasporë), për tekstet shkollore dhe trajnimin e mësuesve ; Sigurimi i teksteve shkollore dhe trajnimi i mësimdhënësve. Dërgimi mësuesve me kontratë në shtetet pritëse.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)**

#### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**
- **Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme**

#### Janar-Mars 2021:

- Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, datë 23.03.2015, *“Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”* është hartuar Vendimi nr. 756, datë 23.9.2020 i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, *“Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën”*, që ka përcaktuar 5 anëtarë nga Kosova dhe 5 anëtarë (4 MASR, 1 Qendra e Botimeve për Diasporën) nga Shqipëria si pjesë e Komisionit të Përbashkët.
- Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën ka hartuar dhe miratuar me Vendimin Nr.1, datë 29.01.2021: Standardet e teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën si dhe paketën e dokumenteve për procedurat e konkurimit për tekstet mësimore të përbashkëta për diasporën.
- Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën ka hartuar dhe miratuar me Vendimin Nr.2, datë

29.01.2021: Kriteret për recensuesit e teksteve mësimore për diasporën dhe shpalljen e konkursit për tekstet mësimore për diasporën.

- Është miratuar Urdhri i Përbashkët Nr. 762/1 prot., datë 9.02.2021 i Ministrit të Shtetit për Diasporën, Nr. 915/1 prot., datë 09.02.2021 e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Nr. 234 prot., datë 16.02.2021 e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës “Për miratimin e paketës së dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën, kriterëve për recensuesit e teksteve mësimore për diasporën dhe shpalljen e konkursit për tekstet mësimore për diasporën”.
- Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, pranë QBD-së, me Vendimin nr. 1, datë 11.01.2021 miratoi propozimin e listës së anëtarëve të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve të Diasporës dërguar për miratim Ministrit të Shtetit për Diasporën.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka përcjellë shkresën Nr. 159 Prot, datë 12.01.2021 drejtuar Ministrit të Shtetit për Diasporën “Mbi anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve të Diasporës e propozuar nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën” nga radhët e arsimtarëve shqiptarë në Diasporë.
- Është përditësuar regjistri shtetëror i mësuesve të diasporës. Mësuesit e diasporës, sipas kriterëve të përcaktuara me Vendimin Nr. 104/2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”, aplikuan në tetor - nëntor 2020 pranë ASCAP, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për t’u bërë pjesë e regjistrin shtetëror të mësuesve të diasporës. Në përfundim të fazës së vlerësimit të dokumentacionit të tyre u miratuan në regjistrin shtetëror të mësuesve në diasporë, 23 (njëzet e tre) mësues.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka vendosur në dispozicion në faqen e saj zyrtare online, pa pagesë, tekstin shkollor “Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare” Niveli 1/2/3. Teksti është hartuar në bazë të programit të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët shqiptarë që jetojnë jashtë kësaj Republike dhe është fitues i konkursit të shpallur po nga kjo Ministri, në vitin 2011.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka botuar dhe ka vënë në dispozicion pa pagesë librin në faqen e saj zyrtare online “Tregime të moçme shqiptare”, me autor Mitrush Kutelin, të përkthyer në pesë gjuhë: anglisht, italisht, greqisht, gjermanisht dhe frëngjisht.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar në faqen e saj zyrtare online (pa pagesë) revistën “Letra nga diaspora”, në gjuhën angleze.

### **Prill-Qershor 2021:**

- Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë organizoi më 22 qershor 2021 “Takimin e Mësuesve të Diasporës”. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve të përfshira në procesin e mësimit në Diasporë në Republikën e Kosovës, Znj.Arbërie Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës dhe Znj.Liza Gashi, Zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë, të cilat diskutuan lidhur me sfidat dhe problematikat që hasin mësuesit jashtë vendit.

Ky takim u organizua në 3 panele: Në panelin e parë u prezantua puna e realizuar nga dy Qeveritë e Shqipërisë dhe e Kosovës, për pajtimin për regjistrimin e përbashkët të mësuesve në diasporë, për ratifikimin dhe vijimësinë e marrëveshjeve të hartuara, për organizimet e përbashkëta të aktiviteteve dhe seminareve, për mundësimin e trajnimeve për mësuesit në diasporë, për nxitjen e marrëveshjeve me vendet pritëse për mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe aty ku jetojnë shqiptarët, etj. Në panelin e dytë u diskutua çështja e organizimit të mësimeve në Diasporë dhe në panelin e tretë mësuesit shkëmbyen përvojën e tyre në mësimeve të gjuhës shqipe në Diasporë.

- Në datë 19.04.2021 është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi për zhvillimin e aktiviteteve të Përbashkëta ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka përcjellë shkresën nr. 142 Prot., datë 25.05.2021 Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe Ministrinë e Evropës dhe Punët e Jashtme “Informacion mbi takimin në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë”. Në këtë takim u diskutuan këto çështje:
  - Koordinimi për planifikimin, botimin dhe shpërndarjen e librave bazë, librave ndihmës dhe mjeteve të tjera mësimore për shkollat me mësime plotësues në gjuhën shqipe në diasporë dhe në mërgatë, në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në vitin 2015-2017.
  - Caktimi i dinamikës për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta, projekteve të përbashkëta dhe evidentimin e disa problemeve organizative të krijuara në ditët e fundit rreth organizimit të mësimit plotësues në diasporë.
- Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën nr. 158 Prot., datë 11.06.2021 informon Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ministrin e Shtetit për Diasporën, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës lidhur me takimin e zhvilluar në datë 09.06.2021 të Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për miratimin e teksteve mësimore për diasporën. Në këtë takim u diskutua mbi procedurën e përzgjedhjes dhe mënyrën e pagesës së recensuesve për vlerësimin e teksteve të përbashkëta për diasporën si dhe në përfundim të diskutimeve u morën këto vendime:
  - Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën ka hartuar dhe miratuar me Vendimin Nr.3, datë 09.06.2021: Për miratimin e “Kalendarit të punës për përzgjedhjen e recensuesve”.
  - Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën ka hartuar dhe miratuar me Vendimin Nr.4, datë 09.06.2021: Për miratimin e “Thirrjes për aplikim të recensentëve”.

Ndër të tjera në mbledhjen e datës 9 qershor 2021 u vendos:

- Organizimi në parim i shpërndarjes së teksteve mësimore për diasporën. Për këtë u propozua formimi i një grupi pune ndërinstytucional me pjesëmarrës nga Drejtoria e Diplomacisë Publike dhe Diasporës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Qendra e Botimeve për Diasporën e Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës.
  - Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e marrëveshjeve ndërqeveritare me fokus mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë.
  - T'u propozohet ministrive përgjegjëse për arsimin në Shqipëri dhe në Kosovë zhvillimi fizik i përbashkët i Seminarit të 16-të Kombëtar për Mësimin Plotësues në Diasporë.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka përcjellë shkresën nr. 2385 Prot., datë 14.05.2021 drejtuar Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë” për “Mbi prodhimin e certifikatave të regjistrimit për mësuesit sipas listës së mësuesëve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë të regjistrit shtetëror përcjellë nga MASR-ja”. Në këtë shkresë Qendra e Botimeve për Diasporën informon se ka prodhur 36 certifikata për mësuesit, sipas listës së përcjellë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
  - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me shkresën nr. 7316 Prot., datë 17.06.2021 “Përcjellja e listës së kërkesave për tekste mësimore për shkollat e mësimin plotësues në Diasporë për vitin shkollor 2021-2020” drejtuar Qendrës së Botimeve për Diasporën ku përcjell listën e kërkesave dhe nevojave të evidentuara për tekste mësimore të të tre niveleve “Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare”. Këto kërkesa janë mbledhur nga përfaqësitë diplomatike, shoqatat e mësuesve të gjuhë shqipe dhe shoqata të ndryshme të angazhuara me mësimdhënien e gjuhës shqipe në Diasporë.
  - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka përcjellë shkresën nr. 3262/2 Prot., datë 30.06.2021 “Kërkesë për pajisje me certifikatë të nxënësve të Diasporës” drejtuar Qendrës së Botimeve për Diasporën ku sipas kërkesës nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme kërkon pajisjen me certifikata për nxënësit që përfundojnë programin mësimor të gjuhës dhe kulturës shqiptare në Zvicër.

### **Korrik-Dhjetor 2021:**

- Qendra e Botimeve për Diasporën ka përcjellë shkresën nr. 266 Prot., datë 14.10.2021 Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë” mbi prodhimin e certifikatave të regjistrimit për mësuesit sipas listës së mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë të regjistrit shtetëror përcjellë nga MASR-ja. Në këtë shkresë Qendra e Botimeve për Diasporën informon se ka prodhur 36 (tridhjetë e gjashtë) certifikata për mësuesit sipas listës së përcjellë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të Republikës së Kosovës,

prezantoi më datë 12 nëntor në Tiranë tekstin e përbashkët “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli I.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka përcjell shkresën Nr. 13464 Prot., datë 30.09.2021, lënda: “Kërkesë për libra nga Biblioteka Ndërkombëtare e Stockholmit”, ku janë përcjellë kërkesa për sigurimin e një sasive librash shqip për grupmosha të ndryshme nga Biblioteka Ndërkombëtare e Stockholmit. Qendra e Botimeve për Diasporën ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 261/1 Prot., datë 11.10.2021 drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën nr. 287 Prot., datë 25.11.2021 drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka kthyer përgjigje shkresës nr.16795 Prot., datë 22.11.2021, “Për kërkesën për literaturë plotësuese për shkollat në Diasporë”.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka përcjellë shkresën nr. 285/2 Prot., datë 25.11.2021 drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, lënda: “Informacion mbi dërgesën e teksteve plotësuese në Greqi”.
- Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën Nr. 190/1, datë 07.07.2021, dhe shkresën nr. 266 Prot., datë 14.10.2021 drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministrinë të Shtetit për Diasporën informon se janë prodhuar 36 certifikata për nxënësit sipas listës së përcjellë nga MASR.
- Qendra e Botimeve për Diasporën, referuar pikës nr. 6 dhe 7 të VKM-së nr. 443, datë 26.06.2019, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në Diasporë”, Urdhrit të Përbashkët nr. 4801 Prot., datë 8.9.2021, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, nr. 4184 Prot., datë 7.09.2021, të Ministrisë të Shtetit për Diasporën, si dhe nr. 01B/294 Prot., datë 29.09.2021, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, “Për miratimin e tekstit mësimor për diasporën “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli I, Vendimit nr. 2, datë 28.07.2022, të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën “Për miratimin e listës së teksteve shkollorë për mësimin plotësues në diasporë për vitin shkollor 2022-2023”, si dhe referuar kërkesave të ardhura me shkresë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën, me nr. 9030 Prot., datë 4.07.2022, “Kërkesat për tekstet shqip për vitin shkollor 2022-2023”, protokolluar pranë QBD-së me nr. 68 Prot, janë siguruar 6411 tekste shkollorë për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë (5134 libra fizikë + 1277 libra digjitalë).
- Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimeve të Shtëpisë Botuese Alban zhvilloi online më 8 tetor 2022 trajnimin për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë. Trajnimi u zhvillua për paketën didaktike “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli I, të hartuar nga Shtëpia Botuese “Albas” dhe Shtëpia Botuese “Dukagjini”, për modulin “Mësimdhënia e gjuhës shqipe për mësuesit e diasporës”. Trajnimi i mbajtur në formatin online në platformën “Zoom” u zhvillua me qëllim që mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë të njihen me përmbajtjen shkencore dhe aspektin didaktik e pedagogjik të mësimdhënies së librit “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli I.  
Tematikat e trajtuara në trajnim ishin:
  - Prezantimi i librit - Qëllimet dhe parimet e krijimit të tekstit,
  - Prezantimi i librit - Struktura dhe përmbajtja,

- Shkrim-leximi fillestar,
- Njohja e gjuhës amtare për komunikim,
- Arritja e rezultateve të të nxënësve,
- Aspekte të mësimdhënies dhe didaktike.

Mësuesit morën gjithashtu udhëzime për përdorimin e tekstit digjital nga specialisti IT i Qendrës së Trajnimeve “Albas”.

Në fund të trajnimit, 112 mësuesit që morën pjesë u pajisën me certifikatën e pjesëmarrjes.

- Qendra e Botimeve për Diasporën organizoi më 17 dhjetor 2022 në Milano të Italisë trajnimin njëditor për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë me temë “Metodat e mësimdhënies me në qendër nxënësit”, i organizuar nga shkolla shqipe “Dora e Pajtimit” në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve për Diasporën, e pranishme gjithashtu në trajnim. Gjatë trajnimit u trajtuan metodat e mësimdhënies me në qendër nxënësin, teknikat më të suksesshme të mësimdhënies, modele të tyre dhe zbatime praktike. Në fund u diskutuan përfundimet dhe u shpërndanë certifikatat e pjesëmarrjes.
- Qendra e Botimeve për Diasporën organizoi në bashkëpunim me Këshillim Koordinues të Arsimit në Diasporë më 18 dhjetor 2022 në Tegerfelden (Kantoni i Argaut) të Zvicrës, trajnimin njëditor për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë me temë “Metodat e mësimdhënies me në qendër nxënësit”. Në trajnim u trajtuan metodat e mësimdhënies me në qendër nxënësin, teknikat më të suksesshme të mësimdhënies, modele të tyre dhe zbatime praktike. Në fund u diskutuan përfundimet dhe u shpërndanë certifikatat e pjesëmarrjes.

NË PROCES

### Masa Nr. 57

Zhvillimi i projektit “Mëso Shqip” dhe “e-book” (shkarkimi online i teksteve shkollor të vendosura në programin arsimor për diasporën) me qëllim shpërndarjen e librave në të gjithë botën dhe krijimin e lehtësirave për të furnizuar të gjithë me materiale plotësuese të nevojshme për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqipe.

**INDIKATORËT :** Realizimi i projektit “e-book” për shpërndarjen e librave on line.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Qendra e Botimeve për Diasporën, në faqen e saj zyrtare (web faqe) ka krijuar një seksion të veçantë për tekstet mësimore, literaturën plotësuese dhe librat për fëmijë, të cilat i ofron falas për mësimdhënien në diasporë. Të gjitha tekstet janë të aksesueshme dhe shkarkueshme falas online. Në kategorinë “Tekste shkollorë”

(<http://qbd.gov.al/tekste-shkollor>) gjenden tri tekste e miratuara nga MAS rishikuar dhe përditësuar nga QBD-ja :

- Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare Niveli 1
  - Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare Niveli 2
  - Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare Niveli 3
- Në të njëjtën kategori gjenden edhe materialet ndihmëse të përgatitura nga specialiste e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, të digjitalizuara dhe aksesueshme falas për të gjithë fëmijët dhe mësuesit në Diasporë:
- “Mësojmë Shqip, Niveli A1”,
  - “Mësojmë Shqip, Niveli A2”,
  - “Mësojmë Shqip, Fletore Tematike, Niveli A1-A2”,
  - “Libri i mësuesit, Niveli A1”,
  - “Libri i mësuesit, Niveli A2”,
  - “Libri i leximeve plotësuese, Niveli A1”,
  - “Përralla dhe legjenda për diasporën, Lexime plotësuese dygjuhëshe”.
- Kategoria “Botime për Diasporën” (<http://qbd.gov.al/botime-per-diaspore>) është pasuruar me numrin e ri të revistës letrare “Letra nga Diaspora”, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, si dhe me katalogun e botimeve të QBD-së ku të gjithë personat e interesuar mund të informohen për të gjitha botimet e Qendrës.
- Qendra e Botimeve për Diasporën përgatiti dhe realizoi video për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë, si përmbajtje e platformës digjitale të mësimdhënies në diasporë. Me synim nxitjen e mësimin digjital, duke qenë se e ardhmja po shkon drejt këtij edukimi, përmirësimin e programit të mësimin të gjuhës shqipe në diasporë me anë të teknologjisë, si dhe lehtësimin e procesit të mësimdhënies në diasporë, u mendua përgatitja e materialeve didaktike me anë të 30 videove të shkurtra demonstruese, të cilat do të përgatiten me përmbajtjen e tekstit “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli I, si dhe të materialeve ndihmëse të sipërcituara.
- Këto video do t’u vijnë në ndihmë mësuesve, nxënësve në diasporë, por edhe nxënësve të huaj që dëshirojnë të mësojnë gjuhën shqipe, duke qenë se edhe interesi për mësimin e gjuhës shqipe është në rritje. Ato do të jenë një mjet praktik i përdorur nga mësuesit në diasporë për të arritur te nxënësit e tyre, duke kapërcyer të gjitha barrierat fizike dhe problemet sociale.
- Këto materiale në format video do të publikohen nga Qendra e Botimeve për Diasporën në kanalin e saj në YouTube dhe në rrjetet e saj sociale, duke synuar që të përbëjnë bazën e platformës “Mëso shqip” dhe do të ndihmojnë në procesin e mësimin të gjuhës shqipe në diasporë.
- Këto video do t’u krijojnë mundësi nxënësve që të mos presin në mënyrë pasive transferimin e njohurive të reja nga mësuesja/ mësuesi tek ata, por të marrin pjesë aktive, t’i rikthehen disa herë videos për të zbërthyer përmbajtjen e saj, të kenë mundësi të marrin shënime, të nxjerrin konceptet kryesore të temës së paraqitur, të ndërveprojnë dhe të diskutojnë me njeri-tjetrin.



**Masa Nr.58**

Vlerësimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse (duke respektuar legjislacionin vendas), për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në shkollat e ambientet edukative ekzistuese në këto vende. (Krijimi dhe nxitja e programeve për mësimdhënien e gjuhës shqipe për fëmijët e emigrantëve shqiptarë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të vendeve pritëse).

**INDIKATORËT** : Realizimi i një aktiviteti vjetor për vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe për gjendjen e hapjes së kurseve në gjuhën shqipe.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Për zbatimin e Masës 58 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën Korrik-Shtator 2021.

**Masa Nr.59**

Vlerësimi dhe orientimi i programeve/donatorëve, të cilët ofrojnë bursa studimore për jashtë vendit drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria. Rivlerësimi për përfshirjen e kushtit të kthimit në Shqipëri (për një periudhë jo më pak se një vit) për të gjithë studentët që marrin bursa studimi për jashtë vendit në kuadër të programeve studimore të donatorëve të ndryshëm për Shqipërinë.

**INDIKATORËT** : Realizimi i informimeve periodike në Komitetin Shtetëror të Diasporës për orientimin e programeve/donatorëve për të cilat ka nevojë Shqipëria.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Është miratuar Vendimi nr.447, datë 22.7.2021 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022”. Agjencia Kombëtare e Diasporës ka publikuar në faqen web manualin shpjegues

për bursat si dhe kazhvilluar një takim informues online për bursat që do të akordohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022.

NË PROCES

## | Masa Nr.60 |

Krijimi i regjistrit të studentëve shqiptarë që studiojnë në universitetet jashtë vendit dhe mbi fushat ku ata specializohen. Krijimi i një projekti për nxitjen e komunikimit midis tyre jashtë vendit.

**INDIKATORËT** : Krijimi i regjistrit studentëve shqiptarë jashtë vendit dhe fushat ku specializohen; Organizimi i aktiviteteve vjetore për informim.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Agjencia Kombëtare e Diasporës bazuar në : Vendimin Nr. 504, datë. 24.6.2020 të Këshillit të Ministrave për “Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa nga Shqipëria dhe Vendimin Nr.447, Datë 22.7.2021 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022”, ka krijuar Databazën e Studentëve nismë që ka në fokus rritjen e ndërveprimit me studentët duke lehtësuar komunikimin midis tyre. Qëllimi i databazës është zhvillimi i një sistemi informatik dhe menaxhimi i të dhënave të nevojshme të studentëve Shqiptarë ne Diasporë. Menu e faqes së web-it : [akd.gov.al/studentet/](http://akd.gov.al/studentet/)

NË PROCES

## | Masa Nr.61 |

Kryerja e një raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve shqiptarë që studiojnë jashtë vendit dhe mbi faktorët që ndikojnë në këtë situatë. Ai do të vlerësohet në Komitetin Shtetëror të Diasporës.

**INDIKATORËT** : Realizimi i raportit vlerësues mbi vështirësitë e studentëve dhe faktorët ndikues dhe informimi i Komitetit Shtetëror të Diasporës.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

**Janar-Qershor 2022**

Agjencia Kombëtare e Diasporës mbështetur në Vendimin Nr. 504, datë 24.6.2020 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë” ka krijuar bazën e të dhënave shtetërore dhe nëpërmjet takimeve me studentë dhe profesorë shqiptarë në diasporë ka vlerësuar dhe tërhequr mendimin në natyrën brainstorming për këtë qëllim.

NË PROCES

**| Masa Nr.62 |**

Krijimi dhe përditësimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës, që funksionojnë në vendet që gjykohen si prioritare për politikën kombëtare mbi diasporën. Krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare në diasporë dhe realizimi i një plan veprimi për komunikimin dhe trajnimin e gazetarëve në diasporë me projekte stimuluese dhe aktivitete vjetore për këtë qëllim.

**INDIKATORËT :** Realizimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës; Realizimi i një aktiviteti vjetor me gazetarët e diasporës.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Janar-Qershor 2022**

Projekti “Gazeta e Diasporës Shqiptare”- është bashkëpunim i Ambasadës së Konfederatës Zviceriane dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Ky projekt ka për qëllim informimin dhe krijimin e lidhjeve të informacionit midis komuniteteve shqiptare në Diasporë dhe Shqipërisë.

**Masa Nr.63**

Organizimi i rrjetit të informimit për median shqiptare dhe të huaj për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë në strukturat përkatëse të vendeve pritëse si dhe në ato të organizatave ndërkombëtare. Krijimi i Forumit të Medias së Diasporës dhe organizimin e një aktiviteti vjetor.

**INDIKATORËT** : Krijimi i rrjetit të komunikimit dhe informimit për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve. Organizimi vjetor i Forumit të Medias së Diasporës.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Janar-Qershor 2022**

Nuk ka informacion të përditësuar për këtë masë.

**Masa Nr.64**

Vlerësimi i cilësisë së faqeve të internetit të institucioneve shtetërorë për informacion të detajuar për komunitetet shqiptare jashtë vendit duke hapur edhe një seksion që i kushtohet kësaj teme (aty ku është e nevojshme). Realizimi i takimeve periodike (çdo 6 muaj) për vlerësimin dhe koordinimin me “kujdestarët” e faqeve të informacionit të institucioneve për nivelin e informimit që këto faqe ofrojnë për diasporën shqiptare.

**INDIKATORËT** : Raportim periodik për cilësinë e faqeve të internetit të institucioneve. Organizimi i një takimi vjetor me “kujdestarët” e faqeve të informacionit në institucionet shtetërore.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) informon nëpërmjet komunikimit elektronik se është ndjekur procesi i organizimit të informacionit në faqet zyrtare nga strukturat shtetërore për interesat e komuniteteve shqiptare në diasporë. Si pjesë e planit të veprimit për këtë masë janë publikimet në faqen web të çdo ministrie në menunë «Diaspora».

Planifikimi dhe realizimi i një fushate informuese mbi :

- Çështje që kanë të bëjnë me migracionin dhe diasporën
- Promovimin në shkallë të gjerë të regjistrimit të migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës (pas miratimit) ;
- Identitetin e shqiptarëve, historinë dhe kulturën shqiptare në diasporë.
- Forcimi i Gazetës “Diaspora Shqiptare” me burime informative për çështje që interesojnë migracionin dhe diasporën dhe trajtimet rreth zhvillimeve më të fundit politike, sociale dhe ekonomike në vend ;

Reflektimi në këtë fushatë të procesit që diaspora dhe migracioni do të jenë pjesë integrale të zhvillimeve politike dhe ekonomike të Shqipërisë.

**INDIKATORËT** : Organizimi i fushatës informuese për regjistrimin e migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës ; Organizimi i një aktiviteti vjetor në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë ;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2021 (periodike)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Brendshme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Janar-Mars 2021:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me shkresën Nr. 1402 Prot, datë 02.02.2021, “Kërkesë për bashkëpunim”, ka kërkuar mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, në lidhje me identifikimin e artistëve të rinj, të cilët mund të realizojnë një bust dinjitoz dhe me cilësi të lartë artistike për figurën e heroit kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut, në kuadër të angazhimit të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Bullgari, për vendosjen e bustit të Skënderbeut në Sofie.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës, me shkresën Nr. 36/1, datë 10.02.2021, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, “Kthim përgjigje”, referuar të dhënave që disponon ka propozuar emrin e një artisti shqiptar të njohur, për realizimin e veprës artistike përkatëse.
- Ministria e Brendshme është angazhuar për saktësimin e adresave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, që është bërë e mundur përkatësisht nga shërbimi i ofruar nga *e-Albania*, nëpërmjet të cilit shtetasit që jetojnë jashtë vendit deklarojnë adresën e tyre dhe ngarkojnë një dokument mbështetës së deklaratës. Kjo deklaratë procesohet nga punonjësi i zyrës së gjendjes civile përkatëse, i cili në fund përditëson adresën e shtetasit jashtë vendit. Në këtë mënyrë, të dhënat në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, saktësohen çdo ditë me deklaratimet që mbërrijnë. Deri më tani janë

procesuar 1475 deklarata, ndërkohë që po shqyrtohen 3021.

- Është ndërmarrë nisma “Dhuro Libra” për shtetasit shqiptarë që vuajnë dënimin në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Greqi dhe Itali. Janë dhuruar rreth 10 mijë libra nga shtëpi të ndryshme botuese në vend, individë dhe institucione të ndryshme, të cilat janë shpërndarë në datë 21 shkurt 2021, në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës amtare. Kjo nismë u mbështet nga Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria e Drejtësisë.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka iniciuar projektligjin “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve Inovative”, një proces konsultimi, i cili do të krijojë më shumë hapësirë edhe për investitorët e diasporës që duan të krijojnë një biznes të ri inovativ në vendin tonë. Projektligji synon përcaktimin e lehtësirave fiskale, programeve dhe masave që mbështesin Startup-et Inovative në fazën fillestare të biznesit (periudha e inkubimit) dhe krijimin e një eko-sistemi të favorshëm për to në Republikën e Shqipërisë. Projektligji parashikon organet shtetërore, të cilat ngarkohen me detyrat dhe kompetencat për mbështetjen e Startup-eve Inovative; përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurat që zbatohen për miratimin, mbështetjen, vlerësimin dhe monitorimin e Startup-eve Inovative.

### Prill-Qershor 2021:

Ministri i Shtetit për Diasporën ka përcjellë shkresën nr. 1341 Prot., datë 10.03.2021 “Kërkesë për përditësimin e informacionit në seksionin *Diaspora*” drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar përmes komunikimit elektronike se janë realizuar këto aktivitete:
  - Hapja e sesionit dedikuar Diasporës në faqen zyrtare të MEPJ; <http://punetejashtme.gov.al/diaspora-new.php>
  - Publikimi i VKM-së për krijimin e regjistrit të Diasporës Shqiptare nëpër botë, në të gjitha faqet e ambasadave;
  - Realizimi i disa aktiviteteve të organizuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në kuadër të promovimit të “Identiteti i shqiptarëve, historia dhe kultura shqiptare në Diasporë”, si për shembull: Është organizuar online takimi në kuadër të identitetit shqiptar, historisë dhe kulturës shqiptare në Diasporë me Ministren për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Olta Xhaçka me 20 (njëzetë) mësues në Diasporë nga vendet e Evropës, SHBA dhe Kanada, me rastin e ditës së mësuesve, “7 marsit”. Përmes këtij takimi u realizuan bashkëbisedime mbi arritjet, problematikat dhe sugjerimet për përmirësimin e punës në të ardhmen. Është organizuar në Prishtinë takimi me Grupin e Punës të Ministrisë së Evropës dhe Punët e Jashtme së Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Jashtme dhe Diasporës të Kosovës, bazuar në Protokollin e Bashkëpunimit të Diplomacisë Kulturore midis dy vendeve. U diskutuan detyrat dhe përgjegjësitë për aktivitetet e përbashkëta arsimore, kulturore dhe historike.
- Takim i Mësuesve të gjuhës shqipe në Diasporë.
- Takimi në Ditën Ndërkombëtare të Remitancave.
- Takime dhe forume të hapura të organizuara nga ambasadat shqiptare nëpër botë, si në Itali, Kanada, Australi, Turqi etj., në kuadër të promovimit të kulturës shqiptare.
- Përfundimi i fazës së parë të procesit të mbledhjes së kërkesave për tekste

shkollore në Diasporë për vitin shkollor 2021-2022.

- Takime me shoqatat shqiptare
- Për krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, nga institucionet shtetërore të Diasporës, janë zhvilluar aktivitete të përvitshme. Ndër këto aktivitete në këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:
  - Takimi i Juristëve në Diasporë 7 Qershor 2021. Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Drejtësisë zhvilloi aktivitetin online “Takimi i Juristëve në Diasporë”. Diskutimi u zhvillua në tre panele: “Vështrim i përgjithshëm”, “Juristët në diasporë dhe roli i tyre në sistemin e drejtësisë” dhe “Rrjetëzimi dhe Ndërveprimi i Profesionistëve në diasporë”.
  - Takimi “Dita ndërkombëtare e Remitancave” datë 16 Qershor 2021. Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Bankës së Shqipërisë zhvilloi aktivitetin “Dita Ndërkombëtare e Remitancave”, duke vlerësuar kështu këtë kontribut të remitancave në dobi të familjeve të vendit si dhe formalizimin e kanaleve të dërgimit të tyre në atdhe, objektiva kryesore këto dhe të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.
  - Takimi i Mësuesve të Diasporës 22 qershor 2021. Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë organizoi më 22 qershor 2021 “Takimin e Mësuesve të Diasporës”. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve të përfshira në procesin e mësimin në Diasporë në Republikën e Kosovës, Znj.Arbërie Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës dhe Znj.Liza Gashi, Zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë, të cilat diskutuan lidhur me sfidat dhe problematikat që hasin mësuesit jashtë vendit.Ky takim u organizua në 3 panele: Në panelin e parë u prezantua puna e realizuar nga dy Qeveritë e Shqipërisë dhe e Kosovës, për pajtimin për regjistrimin e përbashkët të mësuesve në diasporë, për ratifikimin dhe vijimësinë e marrëveshjeve të hartuara, për organizimet e përbashkëta të aktiviteteve dhe seminareve, për mundësimin e trajnimeve për mësuesit në diasporë, për nxitjen e marrëveshjeve me vendet pritëse për mbështetjen e mësimin të gjuhës shqipe aty ku jetojnë shqiptarët, etj. Në panelin e dytë u diskutua çështja e organizimit të mësimdhënies në Diasporë dhe në panelin e tretë mësuesit shkëmbyen përvojën e tyre në mësimdhënien e gjuhës shqipe në Diasporë.

### **Korrik-Dhjetor 2021:**

- Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët me shkresën Nr. 171, datë 13.07.2021me lëndë “Veprimtaria botuese e shkencore e QSPA për vitin 2021 dhe planet individuale të punës studimore nga viti 2021 e në vijim”, informon Ministrit të Shtetit për Diasporën se gjatë vitit 2021 do të realizojë 7 (shtatë) botime dhe 3 (tre) konferenca shkencore, sipas afatit të përcaktuar me bashkëpunorët e QSPA.
- Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët informon se për periudhën Korrik -Dhjetor 2021 janë realizuar konferenca dhe botime shkencore si më poshtë:

Konferenca :

- Kuvendi i parë Ndërkombëtar me temë: “Gjendja aktuale e studimeve mbi Arbëreshët” në datat 27-29 shtator 2021
- Konferencë “*Arbëreshët në fokusin e Shtetit Shqiptar*” në datë 19 nëntor 2021
- Konferencë 25-të vjetore -FEL me temë “Gjuhët e rrezikuara dhe diaspora, Gjendja dhe studimi i Arbërishtes si gjuhë e rrezikuar e Diasporës” në datat 16-19 dhjetor 2021

#### Botime shkencore:

- “*Storia della letteratura albanese*” të Giuseppe Schirò Junior, Nuova Academia Collana: Storia delle letterature di tutto il mondo, 1959
- “*La figlia maledetta*”, të Francesco Santorit, “Aracne editrice” 2014
- “*Discorso sull’origine, i costumi e lo stato attuale degli Albanesi del Regno di Napoli*”, e Engjëll Mashit 1807
- “*Le colonie albanesi d’Italia e la loro letteratura*”, Romë, 1913, Michele Marchianò
- Monografia “*Fyletia e Arbënore prej kanekate Laoshima*” (1867), botim i zgjeruar kritik, me rastin e 200-vjetorit të lindjes së Dhimitër Kamardës.
- Revista shkencore “Continuum
- Materialet e Konferencës së 25-të vjetore ndërkombëtare -FEL me temë “Gjuhët e rrezikuara dhe diaspora, Gjendja dhe studimi i Arbërishtes si gjuhë e rrezikuar e Diasporës”

-Qendra e Botimeve për Diasporën prezantoi revistën letrare «Letra nga Diaspora» në edicionin e nëntë të festivalit mbarëkombëtar “Passaggi” në Fano të Italisë, në takimin Evropë/Mesdhe, i cili këtë vit i kushtohej autorëve të Ballkanit.

-Qendra e Botimeve për Diasporën ishte bashkëpunëtore në organizimin e aktivitetit Ndërkombëtar të Librave për Fëmijë në Stokholm të Suedisë. Aktiviteti letrar një javor përfshiu lexime të librave në gjuhën shqipe nga fëmijë të grupmoshave të ndryshme që jetojnë në Suedi.

#### Korrik-Dhjetor 2022:

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshet informon se për vitin 2022 janë realizuar botime shkencore si më poshtë:

- Numri special i Revistës shkencore “CONTINUUM”, botim vjetor studimor i QSPA-së
- “Gjendja aktuale e studimeve për arbëreshët”. Aktet e Kuvendit të Parë të Studimeve Arbëreshe, QSPA.
- “Arbëreshët në fokusin e shtetit shqiptar”, Aktet e Konferencës Shkencore. QSPA & Instituti i Historisë, ASA.



- “Canti Sacri Delle Colonie Albanesi Di Sicilia”, Giuseppe Schiro, Napoli, 1907. QSPA.
  - “Girolamo De Rada, poeta Albanese”, Vittorio Gualtieri, Palermo, 1930. QSPA.
- Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Diasporën ishte bashkëpunëtore në organizimin e aktivitetit Tryezë e rrumbullakët zhvilluar në datë 7 qershor 2022: “Vlerësimi i kulturës arbëreshe: modeli i Puljes, perspektivat dhe sinergjitë”. Veprimtaria u organizua nga Ambasada e Italisë në Shqipëri, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), Instituti Italian i Kulturës, Zyrat e Rajonit të Puljes në Tiranë, si dhe Teatrit Publik Puljez në Itali, në kuadrin e Javës së Kulturës Italiane në Shqipëri me temë: “Puglia - Albania, Joint for Future - Tirana European Youth Capital 2022”.
- Në kuadrin e veprimtarisë së përvitshme “Tetori i librit” me moton “Libri afron Botën”, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit në kuadrin e një tradite tashmë kulturore të përvitshme për librin dhe leximin, organizuan një Tryezë të Rrumbullakët në datë 11 Tetor 2022, me paraqitjen e botimeve shkencore të QSPA-së që nga krijimi i saj.

## Masa Nr. 66

NË PROCES

Rishikimi dhe vlerësimi i zonës së transmetimit nga televizionet dhe radiot shqiptare kombëtare në të gjitha vendet ku ka komunitete të diasporës dhe migrantësh shqiptarë. Krijimi dhe nxitja e programeve televizive në vend për temën e diasporës dhe protagonizmin e saj në shoqërinë shqiptare. Forcimi i kanalit të televizionit publik TVSH 3 për temën e diasporës. Nxitja për marrëveshje me mediat në vendet pritëse, me qëllim transmetimin prej tyre të programeve për komunitetet shqiptare.

**INDIKATORËT:** Realizimi i një aktiviteti vjetor për programet televizive për diasporën; Projekt për forcimin e kanalit të televizionit publik për diasporën TVSH 3;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Janar-Mars 2021 :**

- Për zbatimin e Masës 66 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën janar-mars 2021.

**Prill-Qershor 2021:**

- Për zbatimin e Masës 66 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën prill-qershor

2021.

### **Korrik-Dhjetor 2021:**

Zbatimi i Masës 66 i referohet 6 mujorit të parë të vitit 2021, për rrjedhojë nuk ka informacion të përditësuar mbi këtë masë për periudhën Korrik- Dhjetor 2021.

NË PROCES

#### **| Masa Nr.67 |**

---

Krijimi i projekteve mediatike që nxisin krijimin e rrjeteve informuese për studentët dhe koordinimin e institucioneve përgjegjëse për arsimin për promovimin e rritjes së programeve të shkëmbimit dhe internship-it, të universiteteve shqiptare me universitetet në vendet pritëse me prani të lartë të studentëve shqiptarë.

**INDIKATORËT :** Realizimi i një aktiviteti vjetor dhe krijimi i projekteve mediatike dhe i programeve të shkëmbimit dhe internship-it.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)**

#### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

#### **Janar-Mars 2021:**

- Për zbatimin e Masës 67 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën janar-mars 2021.

#### **Prill-Qershor 2021:**

- Në kuadër të zbatimit të vendimit Nr. 504, datë 24.6.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për Krijimin e Bazës të të Dhënave Shtetërore të Studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”, Agjencia Kombëtare e Diasporës është në proces zbatimi të këtij vendimi. Baza e të dhënave shtetërore e studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ka si institucioni administrues Agjencinë Kombëtare të Diasporës.

NË PROCES

#### **| Masa Nr.68 |**

---

Organizimi i një plan veprimi të koordinuar mediatik për nxitjen dhe motivimin e

diasporës shqiptare për shfrytëzimin e avantazheve në Shqipëri për qëllime turizmi dhe investimi. Përgatitja nga institucionet përgjegjëse të turizmit e një fushate promovionale, në bashkëpunim me sektorin privat të një pakete që siguron pritshmëritë. Si ikona të kësaj fushate mund të përfshihen figurat të njohura të diasporës në secilin treg.

**INDIKATORËT :** Realizimi i një aktiviteti vjetor dhe plan veprimi mediatic; Përgatitja e një fushate promovionale dhe e një pakete të veçantë për diasporën.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Kulturës

**Korrik-Dhjetor 2021:**

- Për zbatimin e Masës 68 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën Korrik-Shtator 2021.

---

**Masa Nr.69**

**NË PROCES**

Monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës mbi vlerësime 3 mujore (me Buletin periodik) dhe kryerja e informimit në Komitetin Shtetëror për Diasporën dhe në Nënkomisionin për Migracionin dhe Diasporën. Nënkomisioni kur e gjykon do të propozojë që për çështjen e trajtimit të migracionit dhe diasporës Kuvendi të miratojë një rezolutë për këtë çështje.

**AFATI KOHOR: 6-mujori i Parë 2021 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Janar-Mars 2021:**

- Agjencia Kombëtare e Diasporës ka publikuar Raportin Vjetor të veprimtarisë së saj për vitin 2020.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar Raportin Vjetor të veprimtarisë së saj për vitin 2020.
- Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët ka publikuar Raportin Vjetor të veprimtarisë së saj për vitin 2020.
- Në datë 21 dhjetor 2020 u zhvillua online mbledhja me pjesëmarrës Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe Agjencitë përgjegjëse për Diasporën, të cilët raportuan në

Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvend lidhur me realizimet, ecurinë e punës përgjatë vitit 2020 dhe objektivat për vitin e ardhshëm.

- Në kuadër të monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, është zhvilluar “Takimi me koordinatorët” në datë 15 shkurt 2021, me qëllim monitorimin e masave dhe nivelin e zbatimit të tyre nga institucionet përgjegjëse shtetërore, bazuar në formatin *Masë-Indikator-Rezultat*.

#### **Prill-Qershor 2021:**

- Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit. Është publikuar numri i parë (Mars 2021) i Buletinit për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave e masave shtetërore për Diasporën.

NË PROCES

#### **| Masa Nr.70 |**

Vlerësimi nga Nënkomisioni për Migracionin dhe Diasporën dhe Komiteti Shtetëror për Diasporën në mbledhje të veçanta i dokumenteve të raportimit me shkrim të:

- Agjencisë Kombëtare të Diasporës;
- Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
- Qendrës së Botimeve për Diasporën
- Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

**AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

#### **Korrik-Dhjetor 2021:**

- Për zbatimin e Masës 70 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën Korrik-Shtator 2021.

NË PROCES

#### **| Masa Nr.71 |**

Vlerësimi, diskutimi dhe propozime për ndryshime për dokumentin e Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit në Kuvendin Kombëtar të Diasporës Shqiptare. Këto propozime do shikohen si nismëtare për të kryer ndryshimet e mundshme në proces.

**AFATI KOHOR: 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)**

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

### **Korrik-Dhjetor 2021:**

- Për zbatimin e Masës 71 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën Korrik-Shtator 2021.
- 

*NË PROCES*

### **| Masa Nr.72 |**

Përcaktimi i indikatorëve të cilët do të evidentojnë nivelin e zbatimit të masave të vendosura nga kjo strategji. Detyrimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e strategjisë për hartimin e raporteve periodike për masat të marra duke përfshirë të dhëna sasiore edhe cilësore të monitorimit, bazuar në indikatorët e përcaktuar.

### **AFATI KOHOR: 6-mujori i Parë 2021 (periodik deri në 2025)**

#### **INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

### **Janar-Mars 2021:**

- Është miratuar Urdhri Nr.30, datë 17.02.2021 “Për përcaktimin e Grupit të Koordinatorëve për Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025”. Ministri i Shtetit për Diasporën me shkresën Nr. 933 Prot, datë 18.02.2021 i është drejtuar të gjitha institucioneve që janë anëtare në këtë grup pune.
- Ministria e Brendshme ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 933 Prot, datë 24.02.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 1477 Prot, datë 18.03.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Instituti i Statistikave ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 255/1 Prot, datë 23.02.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 933/3 Prot, datë 03.03.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Akademia e Shkencave ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 933/2 Prot, datë 05.03.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.

- Ministria e Kulturës ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 944/1 Prot, datë 08.03.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 933/1 Prot, datë 26.02.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021.
- Në datë 15.02.2021 është zhvilluar online nëpërmjet platformës “Webex”, takimi i koordinatorëve mbi planin e veprimit “Për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës”, për periudhën e 6 (gjashtë) mujorit të parë 2021.

#### **Prill-Qershor 2021:**

- Për zbatimin e Masës 72 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën prill-qershor 2021.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit. Është publikuar numri i parë (Mars 2021) i Buletinit për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave e masave shtetërore për Diasporën.

#### **Korrik-Dhjetor 2021:**

- Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit. Është publikuar numri i parë (Mars 2021) dhe i dytë (Qershor 2021) i Buletinit dhe Buletini i tretë (Dhjetor 2021) për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave e masave shtetërore për Diasporën.

